



FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAIM ZEKA

Kjo opozitë s'mund ta rrëzojë Qeverinë edhe 1 000 vjet

- Boll e shkokërdhavitë është kjo
Qeveri, veçse opozita është
edhe më e shkokërdhavitë

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga
radhët e Nismës Socialdemokrate,
Milaim Zeqa, ka bërë me dije se
opozita nuk ka asnjë shans ta rrëzojë
Qeverinë Haradinaj. Në këtë inter-
vistë dhënë për gazetën "Epoka e re",
ai ka thënë se Qeveria aktuale mund

të rrëzohet vetëm nëse duan part-
nerët e koalicionit qeverisës dhe
amerikanët. Deputeti Zeqa ka kri-
tikuar edhe iniciativat e partive poli-
tike për organizimin e tryezave të
përbashkëta, në të cilat synohet të
arrihet konsensusi nacional rreth

çështjeve të mëdha. Sipas tij, këto
iniciativa janë të kota dhe nëpërmjet
tyre nuk do të arrihet asnjë rezultat.
"Këto tryeza do të përdoren si gjeteth
e fikut për t'i mbuluar problemet
reale të qytetarëve të Kosovës", ka
thënë Zeqa

AKTUALE

A FITOHEM
VIZAT DUKE I
TREMBUR
MUSHKONJAT
DHE MIZAT?!



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

ARRESTIMET
PA PRANGA



LULZIM
TAFI

FSK-JA NIS USHTRIMIN
FUSHOR 'SHQIPONJA 6'

EKONOMI

KOSOVA FITON BETEJËN
LIGJORE NË ARBITRAZH
KUNDËR KOMPANISË 'AXOS'

LIMAJ THOTË SE SHTETI DO TË
OFROJË MUNDËSI PËR PUNËSIM

KULTURË

DOKTRINAT E MËDHA
MORALE

HUBERT GRENIER

SPORT

DYZETË MINUTAT E
PAHARRUESHËM PËR
HAXHI ZEKËN

KARATEISTËT E KOSOVËS NUK
PRANOJNË TË GAROJNË NË
SERBI PA SIMBOLE SHTETËRORE

Hoti: Kuvendi nuk po funksionon

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes
Demokratike të Kosovës (LDK-së),
Avdullah Hoti, ka vlerësuar se Kuvendi i
Kosovës tashmë është bërë jofunksion-
al. Ai ka thënë se Qeveria nuk po e
respekton Kuvendin, pasi nuk po
paraqitet në seanca plenare dhe në

komisione parlamentare. Hoti ka
kërkuar ndihmë nga subjektet politike
për ta nxjerrë vendin nga kriza
institucionale. Sipas tij, LDK-së nuk po i
ngutet të shkojë në zgjedhje, por shteti
nuk mund të udhëhiqet edhe më tutje
nga Qeveria e pakicës



I jepet lamtumira e fundit policit Malsor Dashi

Me nderime shtetërore të premtën në
fshatin Stagovë të Kaçanikut i është
dhënë lamtumira e fundit policit

Malsor Dashi, trupi i të cilit është gje-
tur të mërkurën në lumin Lepenc, pas
katër ditë kërkimesh

RENOVA
PUTZ
Magjioni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

FSK-ja nis ushtrimin fushor 'Shqiponja 6'

Në kuadër të ushtrimit fushor "Shqiponja 6", njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të zhvillojnë operacione taktike në terren me kapacitetet ekzistuese, me ç'rast do të bëhet testimi i tyre në bashkëpunim dhe bashkëveprim me partnerët dhe agjencitë vendore të sigurisë dhe emergjencave



PRISHTINË, 4 MAJ - (ER) Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) të premten ka filluar ushtrimin fushor "Shqiponja 6" i cili do të zgjasë deri më 11 maj. Në një konferencë me gazetarë, drejtori i ushtrimit fushor "Shqiponja 6", gjeneralbrigade Naim Haziri, ka bërë me dije se në këto aktivitete njësitë e FSK-së do të zhvillojnë operacione taktike në terren, përkatësisht në Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Gjilan dhe Novobërdë, me kapacitetet ekzistuese, me ç'rast do të bëhet testimi i tyre në bashkëpunim dhe bashkëveprim me partnerët dhe agjencitë vendore të sig-

urisë dhe emergjencave. "Është fat i madh që, krahas agjencive të sigurisë dhe emergjencave të Republikës së Kosovës në gjithë procesin e planifikimit të këtij ushtrimi, kanë qenë edhe vendet partnere. Qëllimi i këtij aktiviteti është që të realizohet ushtrim fushor në nivel të FSK-së me pjesëmarrje të partnerëve, qofshin ata vendorë apo ndërkombëtarë, si dhe të vlerësohen kapacitetet reaguese në situata komplekse emergjente dhe të sigurisë", ka thënë ai.

Haziri ka treguar se për këtë

ushtrim është dizajnuar situata në funksion të asaj që të gjitha agjencive pjesëmarrëse t'u krijohet mundësia që t'i testojnë kapacitetet e tyre reaguese në kuadër të misionit të tyre kushtetues.

Në emër të agjencive të Republikës së Kosovës ka folur Shpend Tërdeva, i cili ka përgëzuar FSK-në për organizimin e ushtrimit fushor "Shqiponja 6", që është i pari i këtij lloji me karakter ndërkombëtar. Edhe përfaqësuesi i vendeve partnere pjesëmarrëse në këtë ushtrim, koloneli Justin Wagner nga

Ajova, ka thënë se është vit historik dhe i veçantë për këtë ushtrim, meqë për herë të parë FSK-ja është mikpritëse e një ushtrimi fushor të kësaj përmase së bashku me ekipet e specializuara ushtarake të tetë shteteve partnere. "Ne kemi detyrë aktive si Gardë Nacionale që t'i përfaqësojmë partnerët ndërkombëtarë gjatë këtij ushtrimi. Ata do të shërbejnë në detyrën e policisë ushtarake, personelit mjekësor, inxhinierisë, ekipit të bashkëpunimit civilo-ushtarak, njësitë motoristike, çështjeve publike e, po ashtu,

edhe vëzhgues/kontrollues dhe vlerësues të ushtrimit. Kjo vërtet është një mundësi e veçantë trajnimi për këtë grup nga grupi ndërkombëtar, për të punuar së bashku me partnerët tanë të FSK-së si dhe me pjesëmarrësit e tjerë nga agjencitë institucionale të Kosovës", është shprehur Wagner.

Të pranishëm në konferencë kanë qenë edhe përfaqësues nga Shqipëria, Ajova, Mbretëria e Bashkuar, Ushtria amerikane për Evropë, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, KFOR-i, si dhe të institucioneve të tjera.

Rama paralajmëron arrestime të bujshme

TIRANË, 4 MAJ - Përmes dy postimeve të shkurtura në rrjetet sociale, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, shigjeton opozitën dhe paralajmëron arrestime të tjera të bujshme në javët në vazhdim, pas ndalimit të Arbër Çekajt në Gjermani. "Jo se e kërkon Gjermania a bota, po se ne themi atë që bëjmë, e bëjmë atë që themi! E jemi ne e askush tjetër që mund ta kalojë detin që ndan të thënat nga të bërë, sado baltë të na hedhin dhe zjarr marazi të ndezin", ka shkruar kryeministri. Opozitën e qorton në lidhje me deklaratat e lëshuara për dorëheqjen e Saimir Tahirit nga mandati i deputetit. Për opozitën, dorëheqja erdhi pas një pakti mes ish-ministrit të Brendshëm dhe kryeministrit. "Ç'është kjo opozitë



pikë e vrer pas largimit të Saimir Tahirit, e arrestimit të kokave të trafikut të kokainës në Gjermani e Spanjë falë bashkëpunimit tonë ndërkombëtar? Sa gjynah më vjen për ata që ende u besojnë këtyre vulëhumburve pa atdhe! Po duan s'duan këta, Shqipërinë do ta bëjmë!", deklaroi Rama.

Bushati takon Kotziasin, vlerësohet progresi i arritur

TIRANË, 4 MAJ - Në takim të tretë ndërministror të Selanikut në mes të Greqisë, Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë, ministri Bushati është takuar edhe me homologun grek Nikos Kotzias. Në këtë samit ministri Bushati zhvilloi një takim me homologun grek Nikos Kotzias, me të cilin morën në shqyrtim ecurinë e paketës mes palëve në Kretë dhe Korçë, duke vlerësuar përmbylljen me sukses të një pjese të elementëve përbërës të saj dhe shprehën angazhimin për të vijuar me të njëjtin ritëm për të jetësuar zgjidhje të qëndrueshme për çështjet e rëna dakord. Ministri Bushati vlerësoi progresin e arritur në takimin e ekipeve negociatore javën e shkuar ndërsa u shpreh optimist për takimin e radhës që do të zhvillohet në Athinë. Kreu i diplomacisë shqiptare nënvizoi se



disa çështje për të cilat palët kanë dakordësi finale janë në zbatim tashmë dhe po punohet për pjesën tjetër të paketës siç është njohja e patentave apo çështjet e kufirit detar dhe tokësor. Ministri Bushati bëri me dije se do të ketë një tjetër takim me homologun Kotzias për ta diskutuar ecurinë e punës, edhe pse Greqia është një vend i rëndësishëm strategjik për Shqipërinë dhe ka një rol të veçantë në rajon.

"Medalja e Skënderbeut" për babanë e Ilir Konushevcit

Prishtinë, 4 maj (ER) - Në 20-vjetorin e rënies së heroit Ilir Konushevcit, kryeministri Ramush Haradinaj ka nderu-

ar të premtën babanë e këtij dëshmori me "Medaljen e Skënderbeut". "Bacën Halit e nderova me 'Medaljen e

Skënderbeut' në kujtim të djalit të tij, të djalit të Kosovës, Ilir Konushevcit, në 20-vjetorin e rënies. Iliri

është me ne sepse jetësoi lirinë tonë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur konferencën javore

Hoti: Kuvendi nuk po funksionon

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka vlerësuar se Kuvendi i Kosovës tashmë është bërë jofunksional. Ai ka thënë se Qeveria nuk po e respekton Kuvendin, pasi nuk po paraqitet në seanca plenare dhe në komisione parlamentare. Hoti ka kërkuar ndihmë nga subjektet politike për ta nxjerrë vendin nga kriza institucionale. Sipas tij, LDK-së nuk po i ngutet të shkojë në zgjedhje, por shteti nuk mund të udhëhiqet edhe më tutje nga Qeveria e pakicës

EPOKA ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 MAJ - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të premten se Kuvendi i Kosovës është bërë jofunksional. Ai ka theksuar se kabineti qeveritar nuk po e respekton organin më të lartë, pasi nuk po merr pjesë në seanca plenare dhe në komisione parlamentare. "Kuvendi i Kosovës praktikisht është bërë jofunksional. Dy seanca të Kuvendit nuk janë përmbyllur për shkak të mungesës së kuorumit të deputetëve për t'i votuar pikat e rendit të ditës. Edhe më skandaloze është se Kuvendi nuk po respektohet nga Qeveria. Zyrtarët qeveritarë nuk po paraqiten në seanca të Kuvendit. Dhe, zakonisht, ulëset e tyre janë bosh. Po ashtu, ka pasur disa raste kur ministrat nuk janë paraqitur as në komisionet parlamentare. Po harrojnë se Kuvendi është organi më i lartë në vend nga i cili bëhen Qeveria, Presidenca dhe të gjitha institucionet e tjera të Kosovës. Kjo është Qeveri e papërgjegjshme karshi obligimeve kushtetuese që

ka para Kuvendit të Kosovës", ka deklaruar Hoti në konferencën javore të LDK-së.

Po ashtu, ai ka thënë se edhe Qeveria është bërë jofunksionale dhe, sipas Hotit, kryeministri nuk ka asnjë kontroll mbi vartësit e tij. "Qeveria është jofunksionale, pasi secili punon për hesap të vetin. Partnerët e koalicionit qeverisës nuk kanë koordinim mes vete. Nuk ka llogaridhënie dhe është shqetësuese kjo mënyrë se si po drejtohet vendi. Kryeministri nuk ka asnjë kontroll mbi ministrat e kabinetit qeveritar. Jemi bërë gazi i botës me numrin e madh të ministrave dhe të zëvendësministrave. Ata na janë përmendur edhe në Raportin e BE-së për Kosovën", është shprehur Hoti, duke kërkuar nga subjektet politike ta nxjerrin vendin nga kriza institucionale. Sipas tij, LDK-së nuk po i ngutet të shkojë në zgjedhje, por shteti nuk mund të udhëhiqet edhe më tutje nga Qeveria e pakicës. "Është tepër e rëndësishme që të gjitha forcat politike në vend të vetëdijesohen për krizën institucionale në të cilën gjendet vendi. Sa më parë të vetëdijesohet kjo Qeveri dhe ky koalicion i pakicës, se nuk mund



të funksionojnë më këshu, është më mirë për vendin. Neve nuk po na ngutet të shkojmë në zgjedhje, por vendi nuk mund të udhëhiqet nga Qeveria e pakicës", ka theksuar Hoti. Sipas tij, në tryezën e ardhshme të subjekteve politike duhet të konkretizohen temat e tryezës së iniciuar nga LDK-ja. Megjithatë, Hoti ka thënë se temat e rëndësishme kombëtare nuk mund të adresohen me Qeverinë që nuk e ka shumicën në Kuvendin e Kosovës. "Duhet të pajtohemi dhe të vetëdijesohemi të gjithë, se këto tema nuk mund të adresohen në këtë format të qeverisjes. Për t'i adresuar temat e rëndësishme duhen institucione të qëndrueshme dhe që flasin në emër të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Tash e kemi një qeveri të pakicës e cila

nuk flet në emër të shumicës së qytetarëve të vendit", ka deklaruar Hoti, duke shtuar se LDK-ja do të jetë pjesë e tryezës të së martës për ta dhënë kontributin e saj. "Tryezën e kemi iniciuar ne dhe jemi pajtuar që mbajtja e tryezave të bëhet me rrotacion sipas fuqive të partive politike në Kuvend. Tryeza e radhës është caktuar për të martën dhe ne do të marrim pjesë dhe do ta japim opinionin duke kërkuar të arrihet konsensus nga të gjitha forcat politike për ta nxjerrë vendin nga kriza institucionale në të cilën gjendet", ka thënë ai. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, pret që delegacioni i Bashkimit Evropian të japë një vlerësim pozitiv rreth luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë që është kushti i vetëm për liberalizim të

vizave. Megjithatë, ai ka thënë se ka dyshimet e veta për këtë çështje duke parë se si po qeveriset vendi. "Shpresoj se delegacioni i BE-së të japë vlerësim pozitiv për luftimin e krimit dhe korrupsionit, por duke parë se si po ecin punët e kësaj qeverisje, kam dyshime. Në këtë Qeveri janë disa ministra me aktakuza të ngritura e që vazhdojnë të jenë ende pjesë e kabinetit qeveritar. LDK-ja në qeverinë paraprake pati vendosur standard të lartë. Më kujtohet se një ministër pati pasur aktakuzë dhe ai pati dhënë dorëheqje. Ky standard duhet të ruhet nga të gjitha forcat politike që qeverisin vendin. Kjo nuk nënkupton se personit që i ngrihet aktakuzë është fajtor, por ai duhet ta lirojë pozitën derisa të përfundojë procesi", ka theksuar Hoti.

Familjet e turqve të deportuar padisin Qeverinë



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë për media mbajtur të premten ka bërë me dije se familjet e gjashtë shtetasve turq të dëbuar nga Kosova, e kanë paditur Qeverinë e Kosovës për mosrespektim të të drejtave të njeriut. "Unë kam dëgjuar se familjet kanë paditur Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosrespektim të të drejtave të tyre, të caktuara në bazë të ligjeve të Kosovës. Po ashtu, kemi filluar një hetim të brendshëm. Hetimi që vjen nga AKI-ja, shumica e materies nuk është publike, mirëpo e kemi marrë seriozisht atë temë", ka thënë Haradinaj. Më 29 mars në Kosovë ishin arrestuar, më pas dëbuar për në Turqi, gjashtë shtetas turq. Pesë prej të dëbuarve ishin punonjës në shkollat "Mehmet Akif" në Kosovë, pronë e klerikut turk Fethullah Gulen, ndërkaq personi i gjashtë ishte një mjek turk.

Flet për "Epokën e re", Milaim Zeka

Kjo opozitë s'mund ta rrëzo

- Boll e shkokërdhavitë është kjo Qeveri, veçse opozita është edhe më e shkokërdhavitë

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka bërë me dije se opozita nuk ka asnjë shans ta rrëzojë Qeverinë Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Qeveria aktuale mund të rrëzohet vetëm nëse duan partnerët e koalicionit qeverisës dhe amerikanët. Deputeti Zeka ka kritikuar edhe iniciativat e partive politike për organizimin e tryezave të përbashkëta, në të cilat synohet të arrihet konsensusi nacional rreth çështjeve të mëdha. Sipas tij, këto iniciativa janë të kota dhe nëpërmjet tyre nuk do të arrihet asnjë rezultat. "Këto tryeza do të përdoren si gjethet e fikut për t'i mbuluar problemet reale të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Zeka

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 MAJ - Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, nuk beson se Qeverinë Haradinaj mund ta rrëzojë kjo opozitë. Ai ka vlerësuar se opozita është qesharake, duke shtuar se paralajmërimet për mocion mosbesimi po i bën vetëm për propagandë politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zeka ka thënë se Qeveria aktuale mund të rrëzohet vetëm nëse duan partitë që janë në pushtet. "Qeveria rrëzohet veç kur të duan amerikanët, Brukseli dhe kur duam ne që jemi pozitë. Sa për këtë opozitë, kjo Qeveri edhe 1 000 vjet nuk rrëzohet", ka thënë Zeka.

Deputeti i Nismës Socialdemokrate ka thënë se interpelancat që thirren prej kësaj opozite tregojnë për nivelin e saj. "Boll e shkokërdhavitë është kjo Qeveri, veçse opozita është edhe më e shkokërdhavitë. Krejt këto deklarime partitë opozitare i bëjnë vetëm sa për fushatë, sepse nuk e kanë seriozisht. Për mendimin tim, askush këtu nuk po bën opozitë. Shiko se çfarë interpelancash thërrasin. Fëmijët po t'i thërrisin këto interpelanca mua do të më vinte marre", ka deklaruar Zeka. Ai ka kritikuar edhe iniciativat e partive politike për t'i organizuar tryezat e

përbashkëta, me të cilat synohet të arrihet konsensusi nacional rreth çështjeve të mëdha.

Zeka ka thënë se iniciativat e tilla janë të kota dhe po bëhen sa për sy e faqe. "Për mendimin tim, kjo është vetëm me u qitë hi syve të këtij populli të varfër që i ka ardhur shpirti në majë të hundës nga papunësia, mosperspektiva për të ardhmen dhe, mbi të gjitha, nga ajo se iu ka vra shpresa për të ardhmen", ka thënë Zeka, duke shtuar se këto tryeza nuk do të prodhojnë asnjë rezultat. "Kurrfarë rezultati pozitiv nuk japin këto tryeza. Këta liderë politikë që marrin iniciativat të tilla i kanë krejt për kamofllazhë. Përndryshe, ata tërë ditën rrinë me njëri-tjetrin në kafe e restorante duke hëngër darka e dreka. Kështu që, bisedat e tilla kanë mundur të bëhen pa tryeza të tilla. Ma thoni ju se cili është rezultati i tryezës së kaluar të LDK-së? Zero. Cili do të jetë rezultati i kësaj tryeze? Zero. Dhe kur t'i shohin këto, qytetarët e shkretë do të mendojnë se kjo është edhe një lojë kundër tyre", është shprehur Zeka.

"Epoka e re": Z. Zeka, tryeza e radhës e partive politike do të organizohet javën e ardhshme nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). A do të marrë pjesë Nisma?

Zeka: Kësaj pyetje mund t'i përgjigjet vetëm z. Fatmir



Limaj. Unë nuk kam kompetencë të flas nëse do t'i përgjigjet Nisma kësaj kërkesë. Varet krejt prej kryetarit të partisë dhe kryesisë së partisë.

"Epoka e re": Meqenëse keni shkuar në tryezën e parë të organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), a do të duhej të merrnit pjesë edhe në tryezën e PDK-së?

Zeka: Parimisht po. Mendoj se Nisma nuk do t'i ikë asnjë tryeze.

"Epoka e re": Cili është vlerësimi juaj për iniciativat e subjekteve politike, që përmes tryezave të përbashkëta të arrihet konsensusi nacional rreth çështjeve të mëdha?

Zeka: Për mendimin tim, kjo është veç sa për t'u qitur hi syve të këtij populli të varfër që i ka

ardhur shpirti në majë të hundës nga papunësia, mosperspektiva për të ardhmen dhe, para së gjithash, nga ajo se iu ka vra shpresa për të ardhmen. Kurrfarë rezultati pozitiv nuk japin këto tryeza. Këta liderë politikë që marrin iniciativat të tilla i kanë krejt për kamofllazhë. Përndryshe, ata tërë ditën rrinë njëri me tjetrin në kafe e restorante duke hëngër darka e dreka. Kështu që, bisedat e tilla kanë mundur të bëhen pa tryeza të tilla. Ma thoni ju se cili është rezultati i tryezës së kaluar të LDK-së? Zero. Cili do të jetë rezultati i kësaj tryeze? Zero. Dhe kur t'i shohin këto, qytetarët e shkretë do të mendojnë se kjo është edhe një lojë kundër tyre.

"Epoka e re": Nuk besoni se do të arrihet një konsensus nacional për çështje të mëdha

përmes këtyre tryezave?

Zeka: Nuk mund të arrihet konsensus në mënyrë absolute me politikanë, të cilët kanë qenë në hasmëri 20-vjeçare mes vete. Këta në momentin që çohen prej tavolinës, po të ishte e mundur, do ta hanin njëri-tjetrin, do ta vrisnin njëri-tjetrin, do ta çonin në burg njëri-tjetrin. Kështu që, kjo është hipokrizi. Këto tryeza do të përdoren si gjethet e fikut për t'i mbuluar problemet reale të qytetarëve të Kosovës. Prandaj, Nisma dhe kryetari i partisë sonë kurrë nuk i kanë parë këto bisedime me ndonjë entuziazëm të madh. Ne kemi shkuar në këto tryeza vetëm për faktin që mos të mendojë dikush se ne jemi frenues apo sabotues të proceseve politike të Kosovës.

"Epoka e re": Atëherë si duhet të vepron me dialogun me

Qeverinë edhe 1 000 vjet

seriozisht. Për mendimin tim, askush këtu nuk po bën opozitë. Shiko se çfarë interpelancash thërrasin. Fëmijët po t'i thërrisin këto interpelanca mua do të më vinte marre. Ata thërrasin interpelancë për 100 ditët e Qeverisë, kurse ne ishim në 200 ditët e Qeverisë. Pastaj, të thërrasësh interpelancë për rastin e Astrit Deharit nuk ka më marre. Më marre është të thërrasësh interpelancë për Astrit Deharin sesa me dalë në rrugë cullak. Sepse kjo i ka rënë sa për të luajtur me patriotizmin e familjes Dehari, e cila është prej familjeve më të nderuara dhe më të respektuara shqiptare. Kështu që, këto

po përdoren prej partive opozitare vetëm për propagandë politike.

Pse nuk u thirr interpelancë parlamentare për Telekomin e Kosovës, për shitjen e Aeroportit dhe për shitjen e KEDS-it?! Pse nuk po thirrret interpelancë për mungesën e Ligjit për naftën, për kontrollin e naftës, të barnave dhe të mishit?! Një pjesë e deputetëve janë të përzier në këto biznese. Pse nuk po thirrret interpelancë për nxjerrjen e ligjit për medie, sepse shumica e deputetëve kanë portale dhe i paguajnë gazetarët se kujt me ia futë. Unë nuk u frikësohem gaze-

tarëve mercenarë, por u frikësohem gazetarëve të vërtetë, që mendoj se në Kosovë ka pak. Pse sa herë unë kam folur kundër ish-drejtorit të Valëss, Agron Mustafës, nuk më ka cituar asnjë medium. Sepse ai së bashku me Kadri Veselin të gjitha medieve u ka dhënë me hëngër tallë.

"Epoka e re": Sipas jush, Qeverinë Haradinaj nuk mund ta rrëzojë kjo opozitë?

Zeka: Qeveria rrëzohet veç kur të duan amerikanët, Brukseli dhe kur duam ne që jemi pozitë. Sa për këtë opozitë, kjo Qeveri edhe 1 000 vjet nuk rrëzohet.

I jepet lamtumira e fundit policit Malsor Dashi

Me nderime shtetërore të premtën në fshatin Stagovë të Kaçanikut i është dhënë lamtumira e fundit policit Malsor Dashi, trupi i të cilit u gjet të mërkurën në lumin Lepenc, pas katër ditë kërkimesh

KAÇANIK, 4 MAJ - Në fshatin Stagovë të Kaçanikut të premtën i është dhënë lamtumira e fundit policit Malsor Dashi, trupi i të cilit u gjet në lumin Lepenc, pas katër ditë kërkimesh. Dashi u varros me ceremoni shtetërore, ku të pranishëm ishin krerët shtetërorë, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe një numër i madh qytetarësh.

Në ceremoninë e varrimit ishte pjesëmarrës kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili ka thënë se familja duhet të ndihet krenare me djalin e vet. "Sot nuk është ditë e lehtë për ne. Sot po ndahemi me një djalosh të ri, i cili ishte i gatshëm t'i shërbejë atdheut. Po ndahemi nga një kontributdhënës i paqes dhe

lirisë së Kosovës. Familja duhet të jetë e fortë se çfarë djali ka rritur", ka deklaruar Veseli.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka dërguar telegram ngushëllimi duke çmuar lart punën e tij në Policinë e Kosovës. "E nderuar familje Dashi, Ministria e Punëve të Brendshme me pikëllim të thellë pranoi lajmin për vdekjen e Malsor Dashit. Më 28 prill 2018, derisa ishte duke u kthyer nga një detyrë, pësoi aksident. E nderuar familje Dashi, ju shprehim ngushëllime të singërta. Qoftë i lehtë dheu i Kosovës për të!", thuhet në telegramin e MPB-së.

Ismet Dervishi, toger në Kaçanik, ka thënë se Dashi ishte shembull se si duhet shërbyer atdheut.

"Ndihe mi të trishtuar sot. E kemi shumë të vështirë të flasim e të gjejmë fjalë të duhura në këtë çast si ky. Qenka e vështirë edhe për eprorin të gjejë fjalë për policin e vet. Malsori na iku kur i duhej shumë atdheut", ka deklaruar Dervishi. Ndërsa Besim Ilazi, kryetar i Kaçanikut, po ashtu ka shprehur ngushëllime për familjen e policit Malsor Dashi. "Malsori me plot vullnet kishte vendosur që tërë potencialin që i kishte dhënë jeta, ta kthejë në siguri e popullit të tij", ka thënë Ilazi.

Ndërkaq kërkimet për kolegun e tij, Armend Trena, po vazhdojnë ende. Dy policët Malsor Dashi dhe Armend Trena ishin zhdukur të shtunën, pasi rënies së veturës zyrtare në lumin Lepenc.

Serbinë, i cili tash pritet të hyjë në fazën përfundimtare?

Zeka: Dialogun me Serbinë është dashur që prej fillimit deri në mbarim ta udhëheqin njerëzit eminentë. Në këtë proces do të duhej të merrte pjesë edhe opozita. Unë kam deklaruar në foltoren e parlamentit, se një prej udhëheqësve të dialogut me Serbinë është dashur të jetë Albin Kurti. Pastaj, pjesë e bisedimeve për të pagjeturit është dashur të jetë një njeri i kalibrit tim, që ka familjarë të zhdukur dhe jo për të dërguar në këtë proces individë injorantë, të cilët nuk kanë kurrfarë platforme të bisedave me Serbinë.

"Epoka e re": Platforma e Qeverisë për fazën finale të dialogut parashihet që këtë fazë të dialogut ta udhëheqë presi-

dentin i vendit, ndërsa Nisma ka shprehur rezerva për këtë. Pse?

Zeka: Sepse Kuvendi i Kosovës nuk ka nxjerrë kurrfarë rezultatesh përmes të cilëve ne i japim një mandat presidenti Thaçi për t'i udhëhequr bisedimet me Serbinë.

"Epoka e re": Prej që Lista Serbe ka bërë me dije se ka dalë nga Qeveria, opozita vazhdimisht ka kritikuar Qeverinë duke thënë se nuk e ka shumicën në Kuvend. Madje është paralajmëruar se do ta çuar vendin në zgjedhje?

Zeka: Boll e shkokërdhantë është kjo Qeveri, veçse opozita është edhe më e shkokërdhantë. Krejt këto deklarime partitë opozitare i bëjnë vetëm sa për fushatë, sepse nuk e kanë



Projektligji për mësimdhënësit e viteve '90-ta dërgohet në Kuvend

**EPOKA
ERE** **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 4 MAJ - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka dërguar në Kuvend, për lexim të parë, Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti 1990/91 deri në vitin 1998/99. Zëvendësministri i Arsimit, Hëset Sahiti, ka prezantuar në mënyrë të përgjithshme anën përmbajtjesore të Projektligjit për punonjësit e arsimit të viteve të '90-ta. Ai ka theksuar se qëllimi i hartimit të këtij projektligji është njohja dhe përcaktimi i të drejtave lidhur me përfitimet e punëtorëve të punonjësve arsimit, që kanë

punuar nga viti 1990/91 deri në vitin 1998/99.

Përcaktimi i statusit dhe njohja e stazhit të punës përmes përkrahjes financiare për mësimdhënësit, punëtorët profesionalë, personelin menaxhues, administrativ dhe teknik, të shkollave dhe universiteteve të Prishtinës. Ky projektligj, sipas Sahitit, është i rëndësishëm së veçantë për gjithë sistemin e arsimit shqip në Kosovë, duke marrë në konsideratë kontributin e pakompensuar të mësimdhënësve të atyre viteve.

Alush Istogu, drejtor financiar në ministri të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka bërë me dije se përmes këtij ligji synohet të përfitojnë në dy kategori të punonjësve të viteve



të '90-ta: kategoria e parë e mësimdhënësve që kanë punuar prej 5 deri në 10 vjet,

llogaritet një pagë shtesë prej 75 përqindësh nga paga mesatare. Ndërkaq kategoria e dytë e

mësimdhënësve që kanë punuar nga 1 deri në 5 vjet, llogaritet 65-përqindëshi i pagës bazë.

Liderët e shtetit presin në takim shefen e re të UNDP-së

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë pritur të premten në takime të veçanta shefen e re të UNDP-së në Kosovë, Ulrika Richardson. Presidenti Thaçi ka thënë se UNDP-ja ka bashkëpunim të shkëlqyer me institucionet e Kosovës dhe ka kontribuar me projekte të rëndësishme për Kosovën. Ai ka theksuar se UNDP-ja do ta ketë gjithmonë mbështetjen e tij.

Duke e uruar Richardsonin për detyrën e re në krye të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, kryeparlamentari Veseli ka vlerësuar lart kontributin e UNDP-së për avancimin e shumë proceseve demokratike në Kosovë. Veseli ka shprehur përkushtimin për ta vazhduar

bashkëpunimin midis Kuvendit të Kosovës dhe UNDP-së, bazuar në një përvojë të frytshme dhe me rëndësi të madhe për legjislativin e vendit.

Ndërkaq udhëheqja e re e UNDP-së në Kosovë, Ulrika Richardson, bashkëpunimin e deritashëm me Kuvendin e konsideroi të shkëlqyer, ndërsa ka theksuar përkushtimin për ta vazhduar mbështetjen edhe në të ardhmen. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj e ka uruar për detyrën e re Ulrika Richardson, duke e njoftuar për prioritetet qeverisëse si dhe për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Qeverisë dhe UNDP-së.

Kryeministri Haradinaj u zotua se ky bashkëpunim me UNDP-në do të vazhdojë edhe në të ardhmen për realizimin e projekteve në vazhdim ku do të jenë të përfshira të gjitha ministratitë.



Kërkohet konsensus më i gjerë politik për platformën e dialogut me Serbinë



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i kryesuar nga Vjosa Osmani, kryetare e Komisionit, ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës, në të cilën ka shqyrtuar Projektplatformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për normalizimin e

marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Gjatë shqyrtimit të kësaj platforme, anëtarët e komisionit shfaqën vërejtje të shumta në përmbajtjen e saj, ndërkaq u shprehën se, lidhur me dialogun, duhet të arrihet konsensus sa më i gjerë politik ndërmjet forcave politike në vend. Anëtarët e komisionit vlerësuan se shqyrtimi në Kuvend i kësaj platforme duhet bërë me

qëllim të pasurimit të saj me rekomandimet e nevojshme nga të gjitha grupet parlamentare. Pas shterimit të debatit, Komisioni vendosi që Projektplatformën shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, ta procedojë tutje për në seancë plenare.

Dhjetë vjet marrëdhënie diplomatike Kosovë - Gjermani

Jahjaga: Ta forcojmë subjektivitetin në raport me fqinjët

Në dhjetëvjetorin e marrëdhënieve diplomatike në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ish-presidentja Atifete Jahjaga ka folur për aleancën, partneritetin dhe miqësinë e palëkundur në mes të dy vendeve si dhe për nevojën që ky partneritet të thellohet edhe më tutje në fusha të ndryshme, në veçanti atë të edukimit për të rinjtë

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 4 MAJ - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë të premten se Kosova ka përforcuar sovranitetin dhe demokracinë. Por, sipas saj, tani duhet që vendi ta forcojë subjektivitetin në raport me fqinjët në mënyrë që të mos mbeten peng qytetarët. Këto komente ajo i bëri me rastin e shënimit të 10-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Gjermani - Kosovë, me moton "Demokracia më e re evropiane: pavarësia, pluralizmi, integrimi". "Duhet ta forcojmë subjektivitetin tonë në raport me fqinjët tanë, të mos e mbajmë peng të ardhmen e qytetarëve. Çdo ditë duhet ta dëshmojmë pasionin e të rinjve tanë që janë të gatshëm të dalin në skenën ndërkombëtare, në shkencë, art apo teknologji. Institucionet e shtetit kanë nevojë të jenë më të vullnetshme t'i dëgjojnë shqetësimet e të rinjve dhe t'u dalin në krah kërkesave të tyre", ka thënë Jahjaga.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Republika e Kosovës në nisjen e vet si shtet ka pasur menjëherë partner-

itetin, miqësinë, përkrahjen e Republikës Federale të Gjermanisë. Ai ka pohuar se ky partneritet ka ekzistuar edhe më herët, por pas shpalljes së pavarësisë është konfirmuar me njohjen dhe me vendosjen e marrëdhënieve bilaterale diplomatike, marrëdhënie këto që janë zhvilluar në nivelin më të lartë dhe vazhdojnë sot të jenë funksionale në nivel të mirë, të respektuar dhe të besuar. "Gjermania është vend që ka sjellë në Kosovë jo vetëm donacionet, përkrahjen politike, në siguri përmes ushtrisë, por ka sjellë në Kosovë edhe ndjenjën e besimit në perspektivën në të ardhmen, përvojat e saj shumë të çmuara deri tek ajo që në Kosovë njihet dhe çmohet si e tillë, brendin gjerman, një vlerë e besueshme", ka thënë Haradinaj, duke theksuar se në Kosovë është e njohur se marrëdhëniet me Gjermaninë e ngrehin Kosovën dhe brendin e Kosovës.

Duke folur më tej për përkrahjen e Gjermanisë, kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova e ka ndjerë këtë përkrahje përmes proceseve rajonale, siç është procesi i Berlinit, WB 6, që për Kosovën është shumë



domethënë, ngaqë në etapa të caktuara është hetuar një tendencë e mospërfshirjes së Kosovës në proceset integruese, duke pasur parasysh faktin e disa vendeve mosnjohëse dhe pengesave të tjera që kanë rezultuar. "Ky proces na ka dhënë garancinë se Kosova mbetet në binarë të integritetit evropian dhe ne i jemi mirënjohës Gjermanisë, kancelares Merkel për këtë proces që na bashkon neve të Ballkanit mes vete, por edhe na mbanë të orientuar drejt BE-së që është shumë me rëndësi", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Kurse ministrja e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se Kosova duhet të fokusohet në fuqizimin e sundimit të ligjit, sigurinë dhe migracionin, zhvillimin social dhe ekonomik si dhe marrëdhëniet me shtetet

fqinje. Ajo ka thënë se Gjermania është partnere shumë e rëndësishme për Kosovën si dhe është ndër zërat më të fuqishëm që promovon integrimin evropian të saj. "Gjatë 10 vjetëve të fundit ne kemi kaluar nëpër një tranzicion ekonomik, politik dhe shoqëror, por gjatë këtij udhëtimi ne ishim gjithmonë të bashkuar si një vend dhe kjo është perspektiva evropiane", është shprehur Hoxha.

Një nga sfidat me të cilat ballafaqohemi në vitet e fundit, ministrja Hoxha ka thënë se është liberalizimi i vizave. Sipas saj, edhe pse ka vështirësi, kjo nuk i ka bërë njerëzit të kenë dyshime në vlerat evropiane dhe të punojnë shumë për t'u bashkuar dhe për t'i respektuar këto vlera. "Kemi arritur progres, por ende mbetet shumë punë për t'u bërë në rrugën tonë

drejt integritetit. Një pjesë e rëndësishme e këtij progresi është nënshkrimi i MSA-së, marrëdhënies së parë kontraktuale me BE-në", ka deklaruar Hoxha, duke shtuar se MSA-ja ndihmon në zbatimin e standardeve evropiane në fusha të ndryshme si dhe në zhvillimin ekonomik. Ajo ka thënë se Kosova nuk duhet të ketë prioritet më të rëndësishëm se procesin integrues. Sipas Hoxhës, e ardhmja e vendit tonë është integrimi në familjen evropiane. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësuesit institucionalë, të shoqërisë civile dhe personalitete të tjera. Nga një fjalë në këtë konferencë e mbajtur nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, i cili falënderoi kryeministrin për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ambasadori Wolfgang Ischinger.

Presidenti Thaçi dekreton Ligjin për ratifikimin e demarkacionit

"Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, ka dekretuar shpalljen e Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, ka dekretuar shpalljen e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Dekretimi i këtij ligji pasoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ditë më parë ka vlerësuar se ratifikimi i marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nuk ishte në

kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. "Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, ka dekretuar shpalljen e Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Ky dekret ka hyrë sot në fuqi, pas nënshkrimit nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi", thuhet në një komunikatë për media të lëshuar nga Zyra e presidentit të Kosovës. Marrëveshja e



Limaj thotë se shteti do të ofrojë mundësi për punësim

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i shoqëruar edhe nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, kanë vazhduar të premtën takimet me familjet përfituese të asistencës sociale.

GJILAN, 4 MAJ (ER) - Me qëllim të jetësimit të projektit për punësimin e një anëtar të secilës familje që nuk e ka asnjë të punësuar, Limaj dhe Reçica kanë mbajtur një tubim me familjet që ndodhën në skemën

sociale në qytetin e Gjilanit. Zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se është i vetëdijshëm se sa vështirë e kalojnë muajin dhe me çfarë ballafaqohen familjet të cilat nuk e kanë asnjë anëtar të punësuar, megjithatë është

shprehur i bindur se shteti do t'ua ofrojë mundësinë për punësim të gjithë atyre që duan të punojnë.

Numri dy i Qeverisë së Kosovës i ka ftuar të shkojnë në qendra të aftësimin profesional dhe të aftësohen për punë. "Ne i dimë problemet me të cilat ballafaqoheni dhe shqetësimet që keni. Secili e keni nga një histori të veçantë familjare, por në fund emëruesi është i përbashkët: asnjëri nuk jetoni mirë. Unë nuk

jam fort ihtar për të folur për probleme, por qysh me i zgjidhë këto probleme. Jemi këtu për të marrë mbështetjen tuaj. Ne bashkë duhet të dalim nga kjo situatë e cila është e vështirë për ju. MPMS-ja dhe Qeveria e Kosovës i kanë futur në agjendë kryesore familjet që kanë mundësi për punë ta kenë nga një anëtar të punësuar", ka thënë Limaj.

Ndërsa ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender

Reçica, ka thënë se MPMS-ja është e përkushtuar për zbatimin e normave ligjore dhe për hartimin e politikave për rritjen e punësimit. Projektin çdo familje nga një të punësuar, Limaj e kishte prezantuar në fushatën për zgjedhjet nacionale të vitit 2017. Takime të ngjashme ditë më parë janë zhvilluar në Prizren, Ferizaj dhe Suharekë. Këso takime do të vazhdojnë të mbahen edhe në komunitet të tjera.



Për këtë vit presin mbështetje 1 642 projekte bujqësore



PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Një numër i madh i fermerëve dhe agrobizneseve kanë aplikuar për të përfituar përkrahje në projektet e tyre në kuadër të masave mbështetëse të "Programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2018". Janë 1 642 projekte të ndryshme të zhvillimit rural, të cilat janë pranuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB). "Të gjithë ata aplikues që do t'i plotësojnë kriteret e parapara në thirrjen për aplikim, duke u bazuar në Programin për Projektet e Zhvillimit Rural dhe

Udhëzimit Administrativ 2018 për masat e shpallura, për të cilat buxheti i ndarë këtë vit arrin shumën në 19 milionë euro, do të mbështeten përmes granteve investive", është thënë në njoftimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Po në këtë njoftim thuhet se, në krahasim me vitin e kaluar, ka rritje të numrit të aplikuesve me projekte të zhvillimit rural. "Vitin e kaluar në zyrat regionale të AZhB-së kanë aplikuar 1 447 projekte për mbështetje përmes granteve

investive", është thënë në njoftimin e AZhB-së.

Kryeshefi ekzekutiv i AZhB-së, Elhami Hajdari, ka bërë me dije se nga java e ardhshme Drejtoria e Miratimit të Projekteve në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë do ta fillojë vlerësimin e projekteve, bazuar në kriteret e publikuara në kohën e shpalljes së thirrjeve, e që janë edhe tani publike në uebfaqen e MBPZHR-së dhe AZhB-së. Ai ka thënë se kjo agjenci, ashtu si në vitet e kaluara, do të jetë transparente gjatë tërë procesit.

ATK-ja çdo muaj tejkalon planin e të hyrave

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) vetëm për muajt janar - prill 2018 nga të hyrat e rregullta ka mbledhur 162.8 milionë euro. "Në krahasim me periudhën e njëjtë të

vitit të kaluar kemi rritje për 20.1 milionë euro apo 14.2 për qind, ndërsa në raport me planin janë mbledhur 9.4 milionë euro apo 6.1 për qind më shumë të hyra sesa plani i paraparë. Po gjatë kësaj peri-

udhe janë arkëtuar mbi 51.5 milionë euro të hyra për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)", është thënë në njoftimin e ATK-së. Sipas ATK-së, kjo konfirmon se performanca e të

hyrave vazhdimisht është duke u rritur, duke marrë parasysh përkushtimin e menaxhmentit të ATK-së për zbatimin e Strategjisë 2015-2020 si dhe të planeve operative të hartuara për këtë vit.



Kosova fiton betejën ligjore në Arbitrazh kundër kompanisë 'Axos'

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 MAJ - Qeveria e Kosovës ka fituar betejën ligjore në Gjykatën e Arbitrazhit kundër kompanisë "Axos", e cila kërkonte dëmshpërblim qindra miliona euro për anulimin e privatizimit të 75 për qind të aksioneve të Postës dhe Telekomit të Kosovës.

Tani kompania "Axos" obligohet t'i paguajë Kosovës afër dy milionë euro dëmshpërblim. Lajmin e ka bërë me dije ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Luka. "Tribunali i Arbitrazhit për

rastin e privatizimit të Telekomit të Kosovës ka vendosur plotësisht në favor të Kosovës, duke e obliguar kompaninë ACP Axos t'i paguajë rreth dy milionë dollarë në shpenzime të ndryshme", është shprehur Luka.

Edhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, i cili më herët ka qenë ministër i Zhvillimit Ekonomik, ka folur për vendimin e arbitrazhit. "Ky vendim tregon për punën profesionale dhe plotësisht të përgjegjshme të Qeverisë së Kosovës. Si një nga përgjegjësit për një periudhë kohore për këtë proces, nuk kam pasur për asnjë

moment dyshime se epilogu do të jetë ndryshe. Ka pasur shumë paragjykitime dhe etiketime të pabaza dhe të paargumentuara brenda dhe jashtë vendit, por gjithmonë faktet, puna e bazuar në ligje, sinjeriteti dhe dokumentet janë kokëforta. Drejtësia vonon, por fiton", ka thënë Beqaj. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar fitoren e shtetit të Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit kundër kompanisë "Axos". Ai ka thënë se Kosova gjithmonë do t'i mirëpresë investimet e huaja, por asnjëherë nuk do të lejojë të keqpërdoret si shtet. "E drejta dhe të gjitha argumentet në

rastin e padisë se 'Axos'-it ishin në favorin tonë. E uroj ekipin e ekspertëve për punën profesionale dhe mbrojtjen që i ka bërë Kosovës. Si shtet i pavarur dhe sovran jemi pjesë e Arbitrazhit sepse besojmë në këtë institucion dhe në përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare. Kemi ndërtuar kapacitete për të tërhequr investime të huaja, mirëpo edhe për t'i mbrojtur interesat e shtetit tonë nga pretendimet e paqëndrueshme", ka thënë presidenti Thaçi.

Kompania "Axos" kishte bërë padi në adresë të Qeverisë së Kosovës, për arsye, siç thuhej, të

moszbatimit të kontratës së privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës. Në vitin 2013 Qeveria e Kosovës kishte shpallur fituese në blerjen e 75 për qind të aksioneve të PTK-së kompaninë "Axos" me një vlerë prej 277 milionë eurosh. Por, ky proces kishte mbetur i papërfunduar për shkak të mospajtimeve në Kuvendin e Kosovës, çka ishte pasuar me padinë e "Axos"-it ndaj Qeverisë së Kosovës. Aktualisht, Telekomit i Kosovës gjendet në krizë të thellë financiare dhe rrezikon të falimentojë, pasi borxhi i akumuluar ka arritur shifrën e 60 milionë eurove.



Panairi i Punës ofrohen mbi katër mijë vende të punës

PRISHTINË, 4 MAJ (ER) - Mbi katër mijë vende të punës po ofrohen nga 150 kompani private në Panairin e Punës të organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, GIZ-i gjerman dhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, gjatë hapjes së panairit, ka thënë se ngjarja e sotme ka të bëjë me rritjen e punësimit dhe aftësisht profesional. "Ky panair ka karakter promovim dhe vende të punës dhe përçojnë një imazh të mirë për investitorë të huaj", ka thënë Reçica.

Ministri Reçica ka shtuar se ministria që drejton është jashtëzakonisht e përkushtuar për krijimin e mundësive për punësim. Ai ka thënë se një mundësi e mirë për punëdhënësit potencialë dhe punëkërkuarit është krijimi me hapjen këtij panairi. Njëkohësisht është hapur edhe edicioni i tetë i



Panairit Virtual të Karrierës të organizuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Të pranishmëve në këtë aktivitet iu drejtua me fjalë rasti rektori Dema, i cili bëri hapjen zyrtare të Panairit

Virtual të Karrierës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". "Platforma Virtuale e Karrierës i ka

hedhur hapat e saj ngadalë, por shumë sigurt. Andaj, edicioni i tetë i Panairit Virtual të Karrierës e dëshmon më së mirë përkushtimin e vazhdueshëm të menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" drejt implementimit të Planit Strategjik, i njohur si plani i zhvillimit dhe i ndryshimeve thelbësore në Universitetin tonë, ku rëndësi e jashtëzakonshme i kushtohet edhe lidhjes së studentëve tanë me tregun e punës", ka thënë Dema.

Nën moton "Eja, tako punëdhënësin tënd potencial!", ky panair, përveç kompanive që potencialisht mund të ofrojnë vende të punës apo punë praktike dhe organizatave që do të ofrojnë informata rreth bursave, kurseve, trajnimeve e shërbimeve të tjera, në platformën virtuale edhe maturantët do të mund të gjejnë informata për programet e studimit të UPHP-së.

A FITOHEN VIZAT DUKE I TREMBUR MUSHKONJAT DHE MIZAT?!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Loja po vazhdon...: Kosova është vendi i vetëm në Ballkan që nuk ka përfutur nga procesi i liberalizimit të vizave sikur që asaj i janë kërkuar kritere shtesë e që nuk i janë kërkuar asnjë vendi tjetër, për lëvizje të lirë. Duket se këto kritere shtesë i kanë ofruar si bonus drejtuesit e bisedimeve në mënyrë që të dëshmojnë si vendimmarrës të vendosur, pa i treguar fare qytetarëve të Kosovës për këtë surprizë që ua kanë bërë burokratëve të Brukselit, të cilët të rruajnë në të thatë, nëse e vërejnë se je një leshko e në anën tjetër t'i rrahin krahet duke të lavdëruar për lidhshmëri dhe politikan që merr vendime të guximshme. Për këtë situatë njeri më të përshtatshëm se Hashim Thaçin nuk kanë mundur ta gjejnë, madje as kompjuteri më i fuqishëm nuk ka mundur ta nxjerrë një përkryerje të tillë të improvizimit. Pastaj, Hashimi e ka nxjerrë nga harresa politike Edita Tahirin, një llaskuce ordinere që, çështja e Kosovës i ka interesuar aq sa mua më intereson nëse faraoni Tutankamon ishte bërë synet apo jo. Me rastin e Kosovës, BE-ja ka qenë jashtëzakonisht hipokrite duke e trajtuar shumë më keq se Serbinë sikur që Kosova ishte përgjegjëse për luftërat dhe gjenocidin në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe jo Serbia kriminale e cila, përballë Kosovës ka mbetur e tillë edhe sot, madje, nëse e kemi parasysh kontekstin e ndryshuar politik, regjimi aktu-

al i Serbisë është më kriminal se ai i Millosheviqit. Pse e them kështu? Serbia, si përgjegjëse absolute për të gjitha krimet në këto hapësira, në vend se të dënohet në mënyrë meritore sikur që u dënua Gjermania, Italia dhe Japonia për shkak të përgjegjësive për viktimat miliona e miliona të vrarë dhe shkatërrimet marramendëse pas përfundimit të luftës së dytë botërore, po kjo Serbi kriminale u shpërblye nga ndërkombëtarët duke e lejuar që të vazhdojë me krime të tjera në Kosovë, tash me mjete tjera. Pas përfundimit të luftës Kosova asnjëherë nuk u trajtua si subjekt i barabartë por në emër të saj flisnin burokratët e Brukselit dhe regjimi kriminal i Serbisë. Në Serbi nuk ekziston ndjenja e fajësisë apo përgjegjësive për krimet kundër njerëzimit, deri në përmasa të gjenocidit. Në Serbi nuk flitet as për përgjegjësinë individuale, si standard i pranuar ndërkombëtar kundër hakmarrjes kolektive, nëse do të kërkohej përgjegjësia kolektive. Realisht, nëse për një rast mund të thuhet se përgjegjësia e përgjithshme mund të ketë ndodhur, Serbia është shembull konkret për adresimin e kësaj përgjegjësie sepse, për krimet e bëra në Kosovë dhe hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë ishin të përfshira të gjitha strukturat shoqërore të Serbisë, nga Akademia e Shkencës së Serbisë, Kishës Ortodokse serbe, mediet, shoqëria civile, policia, ushtria, paramilitarët dhe përfaqësitë diplomatike të Serbisë nëpër vende të ndryshme të botës. Kosova bëri luftë mbrojtëse dhe për çlirim dhe u ndëshkua kurse Serbia, përgjegjëse për krime të shumta, përfitoi, politikisht dhe ekonomikisht. Dënimi ndaj një individi apo shteti nuk bëhet për t'iu hakmarrë por për të parandaluar rastet tjera të ngjashme e në

rastin e Serbisë vetëm kanë inkurajuar kriminelët potencialë se mund të bëni krime dhe për këtë, jo që nuk do të ndëshkoheni por do të shpërbleheni. Po të zbatohet një drejtësi qoftë edhe e pjesshme, Serbia do të përjashtohet nga çdo prani në Kosovë për së paku 30 vite dhe për atë kohë do të arrihej një stabilizim i situatës kurse serbët e Kosovës shumë më lehtë do të integroheshin duke u bërë pjesë konstruktive e zgjidhjes së problemit dhe duke shërbyer si urë lidhëse për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë! Koha më e mirë për njohje të pavarësisë së Kosovës ka qenë qershori i vitit 1999 kur Serbia ishte në një defensivë të plotë kurse gjendja në terren në Kosovë ishte e tmerrshme. Ndërkombëtarët duket se kishin të tjera plane, e bënë Serbinë partner në vendimmarrje për çështje ekskluzivisht të brendshme të Kosovës ndërsa, në informeshim nga mediet se çka kanë biseduar dhe për çka kanë vendosur ndërkombëtarët dhe Serbia. Të papërgjegjshmit, kriminelët dhe horrat shqiptarë merreshin me uzurpimin e pronave të serbëve, vrasjen e ndonjë plake apo plaku serb për t'iu grabitur pronat, plaçkitjen e çdo gjëje që kishte vlerë si dhe luftën e pamëshirshme për pushtet, në kohën kur nuk kishte shtet, midis shqiptarëve, duke vrarë dhe zhdukur kundërshtarë që ua rrezikonin fitimet gjithnjë duke e maskuar me qëllime politike dhe kombëtare e që nuk ishte fare e vërtetë. Në atë kohë lindi dhe filloi të forcohet struktura e kriminalizuar e një krahu të luftës si dhe të një krahu të rezistencës paqësore. Askush nuk e ktheu një markë të vetme nga fondet Vendlindja Thërrret dhe Fondi i 3%. Pikërisht eksponentët (një pjesë e tyre) e këtyre fondeve u bënë milion-

erë të rinj. Të gjitha këto zhvillime ndodhën para syve dhe në prani të ndërkombëtarëve të cilët vetëm regjistronin të gjitha, që nga grabitjet e deri te vrasjet por nuk intervenonin dhe pastaj, këto i përdornin si mjet shantazhi ndaj strukturave të caktuara politike. OSBE organizonte zgjedhje të Serbisë në Kosovë, në emër të një roli lehtësues dhe në mungesë të kapaciteteve vendore. Procesi i kthimit të personave të zhvendosur, si e drejtë elementare e njeriut e cila ishte dhe është e drejtë e pamohueshme bëhej për t'u forcur prania e serbëve në Kosovë duke krijuar hapësira etnikisht serbe dhe një zinxhiri të pandërprerë, nga Veriu i Kosovës, përmes Dukagjinit dhe Kosovës qendrore, deri te Anamorava, që kufizohet me Serbinë. Ky ishte plani i Serbisë e që përkrahej nga ndërkombëtarët që merreshin me çështjen e refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Askush nuk merrej me çështjen e personave të zhdukur apo ndjekjen e kriminelëve të luftës sepse luhej një lojë e ndytë politike ku Serbia favorizohej kurse ne ishim lojtarë të dorës së tretë. Veriu i Mitrovicës dhe i Kosovës u pas-trua dhunshëm në prani dhe me përkrahje të ndërkombëtarëve, nga shqiptarët të cilëve kurrë nuk iu lejua kthimi në pronat e tyre, duke u bërë refugjatë në vendin e vet. Në emër të një decentralizimi u formuan komuna të pastra etnike në kohën kur na teshnin dhe ende na teshin prapancën me një Kosovë multietnike. Ngjarjet e marsit u keqpërdorën duke vrarë dhe shpërngulur dhunshëm serbë dhe romë, pas së cilave ndarja në baza etnike vetëm sa u fuqizua. Kërkohej përgjegjësi vetëm për ata që kanë vrarë serbë por jo edhe ata që kanë vrarë shqiptarë ndonëse numri i shqiptarëve të vrarë ishte dyfish më

shumë se i serbëve. Tre fëmijë shqiptarë të mbytur me dhunë në fshatin Çabër (lumin Ibër), si pasojë e ndjekjes me qen nga serbët lokalë u harruan sepse, sipas formulimit idiotesk të ndërkombëtarëve nuk po mund të gjendet qeni. Ndërkombëtarët i liruan nga burgu i Mitrovicës 22 serbë dhe romë të dyshuar për krime ndaj shqiptarëve duke inskenuar situatën se paskan ikur dhe kurrë nuk kërkuar nga Serbia që ata të ekstradohen. Sigurisht se ata ishin në Mitrovicë për t'i vazhduar krimet ndaj shqiptarëve të mbetur në atë pjesë të Kosovës së okupuar. Në këtë kohë Kosovës iu shtua edhe një klasë e analfabetëve intelektualë që u pajisën me tituj shkencorë dhe akademikë, për t'u sistemuar pastaj në të gjitha pikat kyçe, nga Akademia e deri te shitësit e kondomëve. Filluan bisedimet në Vjenë ku Kosova përfaqësohej kryesisht nga lakmitarët për para dhe jeshmenët. Pastaj nobelisti i ardhshëm, kriminel i kushtetues, Mati Ahtisari të cilin Hashim Thaçi dhe Fatmir Sejdiu e përmendnin më shumë se baballarët e tyre biologjik, i bëri serbët e Kosovës "nebeski narod" (populli qiellor), duke e realizuar kështu synimin e përcaktuar të kriminelit Sllobodan Millosheviq për serbët, si "nebeski narod". Serbët e Kosovës 100% i shërbenin Serbisë dhe 100% punonin kundër Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare kërkonte për ta më shumë se që ua ofron këto të drejta pakicave kombëtare në shtetet e tyre. Përkundër se kjo çështje është shumë mirë e rregulluar me të gjitha dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e që është shndërruar në standard ndërkombëtar, ndërkombëtarët kërkonin nga ne edhe më shumë, Ahtisari + (shtet brenda një shteti jofunksional). Gjatë procesit të Demarkacionit me

Maqedoninë. Sipas traditës historike Maqedonia i mori një kafshatë të territorit të Kosovës por se nuk u bë shumë e madhe sepse Kosova ishte në fazën e shtetndërtimit. Me Malin e Zi ky tregim u përsërit në një formë më të vrazhdë, me kushtëzim se nëse nuk pranohet ky Demarkacion, nuk do të ketë liberalizim të vizave. Kjo u keqpërdorë skajshmërisht nga ata që donin ta ruanin pushtetin apo ta merrnin pushtetin, gjithsesi interpretimi ishte nga këndi i interesit të tyre. Hashim Thaçi e bëri një marrëveshje me Vujanoviçin kinse për korrigjim të kufirit, nëse ka ndodhur ndonjë gabim e që me gjuhë të popullit do të thotë se po lahet m.. me sh.... Hashimi, si nënshkruar i marrëveshjes, me endacaken e Brukselit, Edita Tahirin nuk ka mundur të veprojë ndryshe. Me këtë manipulim të ndyrë dhe me presion ndaj deputetëve të partisë ku ishte i siguroi votat për kalim të Demarkacionit duke i krijuar një arsyetim edhe Ramush Haradinajt të lëvizë nga pozicionet e forta që i kishte më parë. Realisht, Hashimi ia la këmbët e arushës në dorë Ramushit. PDK-në, ia la në duar Kadrisë i cili e pati dhe e ka vështirë të transformohet nga një lider i një shërbimi informativ në një lider politik, aq më parë që komunikimi i një lideri të shërbimit informativ dallon nga një komunikim që e bënë një lider politik. Ky tranzicion Kadrisë po i shkakton problem aq më parë që Hashimi, edhe tash llogaritet Zeus i PDK-së sepse aty ka lënë çimka që e informojnë për çdo gjë dhe i binden për çdo gjë. Për Kadrisë është shumë më mirë që në zgjedhjet e ardhshme të dalë si kandidat i pavarur apo me një parti të re se të vazhdojë ta mbajë në duar orën e kurdisur me shpërthyes, pilotin e të cilit e mbanë ende Hashim Thaçi. Tash, bashkësia ndërkombëtare po insiston që sa më parë të formohet Asociacioni i Serbisë në Kosovë (komunat me shumicë absolute serbe) si kusht për t'u integruar të rrotë të së ëmës. Hashimi pati thënë se ky Asociacion do të jetë një OJQ siç janë mbi 8000 në Kosovë dhe për të e kanë nënshkruar një marrëveshje në Bruksel. Me sa e di unë, e kam përvojë të gjatë në këtë fushë, për herë të parë po ndodhë që një OJQ e Kosovës të regjistrohet në Bruksel. Qartazi, Hashimi i madh po luan lojë me hashimët e vegjël! Edhe ndërkombëtarët po kërkojnë që ky Asociacion të formohet sipas ligjeve të Kosovës por të ketë disa kompetenca ekzekutive. Çfarë hipokrizie dhe çfarë poshtërsie! Interesat e qytetarëve, pa dallime i mbron ligji dhe shteti dhe jo Asociacioni.

Ma gjeni një vend në botë ku Asociacioni ka kompetenca sikur ky në Kosovë. Nuk mund ta gjeni sepse asnjë vend normal nuk e lejon këtë. Edhe për Asociacionin do të gjendet një formulim sikur për Demarkacionin, larje e m.. me sh..!

Ndërkombëtarët e formuan Gjykatën Speciale, jo për të ndarë drejtësi për viktimat dhe përgjegjësi për kriminelët por për të bërë shantazh mbi politikanët që të bëjnë lëshime politike. Kjo Gjykatë është politike dhe si e tillë do të dështojë 100% sikur edhe ajo e Hagës, e UNMIK-ut dhe EULESH-it. Këta që po frikohen nga kjo Gjykatë po a bëjnë tutën për së rëndi dhe kot. Gjykata do të përdoret për arritjen e një marrëveshjeje politike me Serbinë ku Kosova do të ndahet e lagur dhe pas kësaj, pasi të hapen letrat dhe t'i shohim zhvillimet në terren, Kosova do të hyjë në një krizë të vërtetë. Pikërisht për këtë arsye nuk po lejohet formimi i ushtrisë së Kosovës sepse me 10,000 policë profesionistë dhe të motivuar, me 8-10,000 ushtarë dhe me 100.000 vullnetarë, Serbia vështirë do t'i hyjë aventurës së një lufte të re.

Serbia po bënë përpjekje që në planin afatgjatë ta mbajë Kosovën nën presion duke mos e investuar asnjë cent të vetëm por duke e shfrytëzuar buxhetin e Kosovës dhe serbët e instrumentalizuar kurse përkrahje të plotë po i jep një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare dhe një pjesë e politikanëve kosovarë, lakmitarë dhe injorantë. Bashkëdyzimi i injorancës dhe lakmisë është shkatërruese edhe për shtetet më të fuqishme e lëre më për Kosovën e lodhur dhe të dhunuar nga hamshorë të pashpirt dhe intelektual të tredhur! Në këtë drejtim po insistohet që të vazhdohen bisedimet me Serbinë për të arritur një marrëveshje detyruese (kryesisht vetëm për Kosovën) ku peshku apo mashtruesi shumë më i madh, Aleksandar Vuçiq do ta hajë mashtruesin apo peshkun më të vogël, Hashim Thaçin. Është një luftë krejtësisht e pabarabartë ku dominon Vuçiq, një ish-paramilitar i veshur me petkun e një demokrati, të cilit, për arsye politike i beson faktori ndërkombëtar ndaj një ish-ushtari të UÇK-së, të cilit për arsye, gjithashtu politike nuk i beson aspak faktori ndërkombëtar kurse duket se në Kosovë, përveç meje nuk i beson askush. Qofsha i gabuar 100%, mirëpo jam i sigurt se marrëveshja Vuçiq-Thaçi është në sirtar dhe njëherë nuk bëhet publike për t'i fashitur dhimbjet të cilat nuk do të përfundojnë me formimin e Asociacionit!

ARRESTIMET PA PRANGA

Përrjashtimisht veprave penale të kapura në flagrancë (në kryerje e sipër) dhe vetëm kur ajo është e domosdoshme, askujt nuk mund t'i vendosen prangat në rast se ai person nuk e ka përdorur forcën (duart) gjatë kryerjes së një veprave penale ose nuk ka ikur nga ndjekja penale apo nuk ekziston rreziku i ikjes.



Lulzim Tafa

Pse lidhet njeriu?

Njeriu mund të lidhet vetëm atëherë kur gjatë kryerjes së një veprave penale manifeston dhunë (forcë) andaj masa e prangimit është e domosdoshme për ta neutralizuar dhunën dhe forcën e atij çasti të manifestuar nga kryerësi i një veprave penale të caktuar mbi objektin e veprës penale. Po ashtu, edhe në rast se kryerësi i një veprave penale nuk u është përgjigjur në ftesë organeve të zbatimit të ligjit, pra ka ikur nga drejtësia apo ekziston një rrezik, mirë i supozuar, që ai person ndaj të cilit ka filluar ndjekja penale, do të ikë. Duart pothuajse janë organet/gjymtyrët kryesorë me të cilat një person e kryen një vepër penale me karakter apo kualifikim të dhunshëm. Jo të gjitha veprat penale janë të dhunshme, madje shumica nuk janë. Përrjashtimisht veprave penale kundër jetës dhe trupit si: vrasja, lëndimi i rëndë trupor, lëndimi i lehtë trupor, pjesëmarrja në rrahje etj., apo veprat penale nga kapitulli i veprave penale kundër integritetit seksual, si: dhunimi apo vepra penale "pengim i personit zyrtar", veprat penale kundër pasurisë, si: grabitja, vjedhja, detyrimi etj., dhe veprat penale që kanë të bëjnë me terrorizmin e dhunshëm apo krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, dhunës në familje e të ngjashme, për asnjë lloj tjetër të veprave penale ku nuk është përdoruar forca nuk ka arsye të prangoset njeriu. Pra, efekti apo ideja e prangosjes është që njeriut të

dhunshëm t'i pasivizohen duart si gjymtyrët kryesorë, që të mos ushtrojë dhunë dhe që i njëjti të mund të transportohet pa penguar qoftë në gjykatë apo në burg. Legjislacioni duhet të përcaktojë qartë se te cilat lloje të veprave penale duhet të zbatohet masa e prangimit.

Çfarë janë prangat?

Sipas asaj që thonë fjalorët, prangat janë hallka hekuri për t'i lidhur duart një të arrestuari a një të burgosuri. Historikisht është e njohur si zinxhir me të cilin u lidhnin këmbët e duart skllëverve, edhe pak më thjesht (gjithëherë sipas fjalorëve) diçka që të mban të lidhur, të mbërthyer a të ndrydhur dhe të pengon të veprosh.

Rusoi (Zhan Zhak Ruso), një filozof dhe luftëtar për barazi dhe ligji, thotë se "njeriu lind i lirë, por kurdo ai është në pranga". Rusoi u pëlqen të gjithëve, sidomos filozofëve dhe pasionantëve të vet, madje Kanti thoshte se roli i tij në filozofinë morale është i barabartë me atë të Njutonit në fizikë. Mbase në vlerësimin tim ky admirim i Kantit gati deri në adhurim për Rusoin do t'i ketë ardhur nga koncepti i tij për ligjin dhe librin e tij "Kontrata sociale", pavarësisht se përkufizimet e tij për ligjin janë të natyrës filozofike e më pak juridike, edhe pse ndryshimi është fare i vogël, ngaqë edhe në aspektin juridik ligjet janë humane dhe shërbejnë ngjashëm si në përkufizimet e Rusoit. Njësoj është edhe dënimi. Nëse ligji është human atëherë edhe dënimi duhet të jetë human sepse buron nga ligji. Që do të thotë se dënimi nuk duhet ta manifestojë mundim e as përbuzjen e delikuentit sepse humanizmi është ndër karakteristikat kryesore të dënimit. Ajo që është më e keqja, është se prangat i vendosen edhe njeriut ende të padënuar që, sipas legjislacioneve penale bashkëkohore dhe kushtetu-

tave të vendeve demokratike të shumicës së shteteve në botë, por edhe të konventave ndërkombëtare, konsiderohet i pafajshëm, pra derisa një gjykatë kompetente me juridiksion nuk jep aktgjykim të formës së prerë.

Po çka është dënimi dhe si e përkufizon atë legjislacioni penal?

Dënimi është masë represive që zbatohet ndaj kryerësve të veprave penale. Edhe prangat janë masë represive (në vlerësimin tim).

Por a është e drejtë që prangat të përdoren për qëllime të përluljes dhe poshtëritimit të personit që vetëm supozohet se ka kryer një vepër penale, posaçërisht në fazën e të ashtuquajturit "Prezumimit të pafajësisë", mendoj se jo.

Ka kohë që jam duke shfletuar literaturë e ligje të Kosovës (përfshirë edhe Ligjin për Policinë), por edhe të vendeve të rajonit të BE-së e më gjerë që lidhet me këtë çështje. Të them të drejtën, as mbështetje e as bazë ligjore për prangim nuk po gjej, përrjashtimisht asaj që quhet "siguri për policët", në ndonjë akt nënligjor apo rregullore të brendshme. Pavarësisht prej mirëkuptimit për punën që e bën Policia për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve, prangimi i njeriut pa qenë nevoja është i papranueshëm. Tekefundit, janë disa profesione, siç është ky i policisë, që janë të detyruar, apo së paku duhet të jenë të detyruar t'i ekspozohen rrezikut.

Pra, për ta thjeshtësuar edhe më shumë, njeriu nuk duhet të prangoset nëse nuk ka ushtruar forcë për kryerjen e një veprave penale, nuk ka ikur nga drejtësia dhe nuk ekziston rreziku i ikjes. Ligji duhet të përcaktojë saktë se cilat vepra penale dhe në cilat raste mund të përdoren prangat, në asnjë rast tjetër njeriu nuk duhet të lidhet. PIKË.

(Autori është profesor i së Drejtës Penale)

Peja përkujton dëshmorët e kombit

PEJË, 4 MAJ (ER) - Nën organizimin e shoqatave dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të premtën janë bërë homazhe në të gjitha varrezat e dëshmorëve në Komunën e Pejës, ndërsa sot (e shtunë) në orën 12:00 do të bëhen homazhe në qendër të qytetit, konkretisht te lapidari i dëshmorëve në Sheshin "Shkëlzen Haradinaj". Pas homazheve, të shtunën në Kinoteatrin "Jusuf Gërvalla" në

Pejë, duke filluar nga ora 13:00, do të mbahet akademi përkujtimore. Po të shtunën nga ora 14:30 do të fillojnë garat sportive, tashmë tradicionale në shenjëtari, streetball dhe në shah. Gjithashtu, edhe të dielën në orën 11:00 do të zhvillohen gara në futboll dhe në pingpong. Të gjitha këto aktivitete që organizohen nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së janë tradicionale në Komunën e Pejës.



Të dielën përkujtohet heroit Luan Haradinaj

DEÇAN, 4 MAJ - Më 6 maj, në 21-vjetorin e rënies, përkujtohet heroit i kombit, gjeneral-major Luan Haradinaj. Në orën 11:00 (6 maj) do të bëhen homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Glllogjan, kurse në orën 11:30 do të bëhen

homazhe te shtatorja e heroit Luan Haradinaj në Deçan. Luan Haradinaj ka rënë dëshmor në një rënje prej betejave të para të UÇK-së kundër forcave pushtuese serbe, më 6 maj të vitit 1997, në kufirin shqiptaro-shqiptar.



Qendra për Arsim 'Gjon Nikollë Kazazi' shënon ditën e shkollës

GJAKOVË, 4 MAJ (ER) - Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi" ka shënuar të premtën ditën e shkollës. Në këtë festë ishin të pranishëm kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini me bashkëpunëtorë, drejtorë shkollash, përfaqësues fetarë, nxënës e mësimitdhënës. Fillimisht dita e shkollës u shënuar me prezantimin e punimeve të nxënësve në profile të ndryshme si Informatikë, Elektroteknikë, Mekatronikë dhe Ekonomi. "Është jashtëzakonisht me rëndësi për të gjithë ne të dimë që jeta është një sfidë, nuk është e lehtë, por edhe

shpërblimet mund të jenë shumë të mira. Kam pasur rast të takoj shumë të rinj të cilët kanë një profesion të caktuar, kanë një diplomë universitare por në drejtimin e tyre. Kërkesa për punësim është shumë e vogël krahasuar me kuadrin që diplomon. Andaj nga këtu ju bëj thirrje që, kur ta bëni përzgjedhjen e profesionit, ta bëni duke u bazuar në tregun e punës në mënyrë që mos të dilni në pension pa bërë asnjë ditë punë në profesionin tuaj", ka thënë Gjini. Ndër të tjera, në këtë ditë u ndanë mirënjohje për bashkëpunëtorët e shkollës dhe nxënësit e dalluar.

Banorët e Shipolit shkojnë në Komunën e Mitrovicës me kërkesa

MITROVICË, 4 MAJ (ER) - Nën kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka prituri në takim kryetarin e Shipolit, Salih Mehaj, me të cilin ka diskutuar për problemet dhe sfidat e këtij mjedisi dhe për mundësitë e zgjidhjes së tyre përmes një bashkëpunimi edhe më të ngushtë. Fillimisht, përfaqësuesi i Shipolit, Mehaj, e ka njoftuar nënkryetarin Mujka me problemet kryesore të kësaj paralgje. "Ajo që duhet urgjentisht të veprimet së bashku, qytetarët e Shipolit dhe komuna, është mbajtja e pastërtisë së duhur në

lagje. Në hapësirën përreth ambulancës janë grumbulluar mbeturina të shumta që po e ndotin ambientin dhe po i japin një pamje të shëmtuar mjedisit. Komuna përmes inspeksionit duhet të reagojë, ndërsa ne qytetarët do ta ndihmojmë për pastrimin e mjedisit", ka thënë Salih Mehaj, duke shtuar se duhet të intervenohet menjëherë edhe në oborrin e xhamisë tek varrezat në Shipol. "Në planin më afatgjatë kemi nevojë për një çerdhe fëmijësh, për rregullimin e disa rrugëve që ende kanë mbetur pa u trajtuar,

për rregullimin e hapësirave publike, për ndërtimin e pllakës përkujtimore për të rënëit e Shipolit gjatë përpjekjeve për çlirim nga Serbia, për ruajtjen e pronës publike etj", ka thënë Mehaj. Nën kryetarin e komunës, Faruk Mujka, i ka thënë përfaqësuesit të Shipolit se të gjitha kërkesat e parashtruara janë të arsyeshme. Ai ka bërë me dije se komuna do të angazhohet maksimalisht për zgjidhjen e tyre, por që kjo varet edhe nga ajo se sa lejoni mundësitë e kufizuara buxhetore.



Haradinaj: Është vlerë njerëzore të respektohet gjuha e tjetrit

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 MAJ - Republika e Kosovës ka kornizën më të avancuar ligjore në fushën e të drejtave gjuhësore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve përcaktojnë që gjuha shqipe dhe serbe gëzojnë statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, përdërisa gjuhët e komuniteteve të tjera si gjuha boshnjake, turke dhe rome gëzojnë statusin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në komuna. Kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në hapjen e Konferencës së pestë vjetore të Asociacionit Ndërkombëtar të Komisionarëve të Gjuhëve, organizuar nga Zyra e Komisionarit për Gjuhët pranë Zyrës së Kryeministrit, me temën "Shumëgjuhësia: vlerë dhe/apo obligim". "Kosova është specifikë për sa iu përket gjuhëve dhe ka dygjuhësinë zyrtare. Pra, Kosova është një prej vendeve që i ka dy gjuhë zyrtare, gjuhën shqipe dhe atë serbe. Gjuha serbe, si gjuhë zyrtare në zbatim ka disa vështirësi, pra me Kushtetutë, me ligje është gjuhë zyrtare, por që në zbatim ka disa vështirësi. Ato vijnë edhe në

përkthim, në përgatitje të legjislacionit me kohë, veçanërisht në komunikim në të gjitha nivelet", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se Qeveria vazhdon t'u japë mbështetje angazhimeve të Komisionarit për Gjuhët në Kosovë. Në fjalën e tij, para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka pohuar se është vlerë njerëzore të respektohet gjuha e tjetrit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë disa iniciativa në mënyrë që të zbatohet Ligji dhe të arrihet liria e gjuhëve. Aktualisht është duke u punuar në konceptdokumentin për formimin e njësisë për përkthime, njësi kjo që do ta udhëheqë procesin e përkthimit të legjislacionit qysh nga faza e parë e përgatitjes dhe do të përfshijë redaktimin dhe lekturimin, si përpjekje që të arrihet standard më i lartë i përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit shumëgjuhësh në Kosovë.

Kryeministri Haradinaj ka shtuar se Qeveria ka përgatitur dhe aprovuar planin aksional për adresimin e rekomandimeve të raportit të vendit 2018 të Komisionit Evropian, i cili parasheh edhe miratimin e Strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhë-



sore.

Në këtë konferencë ndërkombëtare morën pjesë Slavisha Mladenovic, Komisionari i Gjuhëve në Kosovë, komisionarë nga vende të ndryshme të botës, si dhe ambasadorë të akredituar në Kosovë.

Po ashtu, edhe kreu i shtetit, Hashim Thaçi, në hapjen e kësaj

konferencë ka thënë se arsimi në gjuhët e komuniteteve joshumicë, përdorimi i tyre në media, administratë publike dhe gjyqsor është jetik për një vend demokratik. "Kosova ka krijuar kushtet e duhura për t'u mundësuar të gjithë qytetarëve që lirshëm të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë identitetet e tyre gjuhë-

sore, duke ua garantuar këto të drejta përmes Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se si një shtet i ri, Kosova ka legjislacionin më të avancuar gjuhësor në Ballkan dhe ka uruar të jetë model edhe për shtetet e tjera fqinje.

Ministri Gashi në ShBA: Kosova së shpejti do të bëhet me kamp rinor

Nju Jork, 4 maj (ER) - Vizita e realizuar në Shtetet e Bashkuar të Amerikës, e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka përfunduar me takime të shumta të cilat janë realizuar me drejtuesit e lartë të YMCA-së në ShBA.

Vizita disaditore e realizuar në Nju Jork e ministrit Gashi ishte një mundësi e mirë për të marrë mbështetje për realizimin e përpjekjeve të MKRS-së që në zbatim të Strategjisë për Rininë ta avancojë pozitën e të rinjve të Republikës së Kosovës.

Ministri Kujtim Gashi, në kuadër të vizitave që ka realizuar, është takuar edhe me Jerry Huncosky, drejtor i Frost Valley YMCA, me ç'rast i është garantuar mbështetje e fuqishme për ndërtimin e një qendre multifunktionale rinore në Republikën e Kosovës.

Qendra multifunktionale edukativo-rinore, e cila do të ndërtohet në fshatin Pjetërshan të Gjakovës, do të jetë në funksion të edukimit joformal dhe promovimit të vlerave të larta pro amerikane dhe evropiane për të rinjtë e vendit tonë. "Qeveria e Republikës së Kosovës dhe unë si ministër nuk do të ndalemi së



angazhuari që në përputhje me strategjinë tonë për rini të zhvillojmë politika progresive të cilat do të ndikojnë dukshëm në nxitjen e rinisë së vendit tonë në aktivitete dhe programe edukative dhe sociale", ka thënë ministri.

Ndërtimi i objektit të YMCA-së në vendin tonë, e cila do të fillojë së ndërtuari gjatë këtij viti në partneritet mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatës GWY në Kosovë, e cila është anëtare me të drejta të plota në Federatën Evropiane të YMCA-s dhe drejtohet nga

Dorina Iluka-Davies, do t'u hapë perspektivë mijëra të rinjve për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në aktivitete të shumta rinore dhe edukative të cilat po i zhvillon kjo organizatë.

Ministri Gashi ka falënderuar drejtuesit e GWY-s për Kosovë, për kontributin e dhënë gjatë kësaj kohe si dhe përpjekjet e tyre për ndërtimin e kësaj qendre, duke theksuar se ka qene synim i tij që Kosova të bëhet me një qendër të tillë e cila gjatë tërë vitit do t'i përfshijë të rinjtë në aktivitete dhe organizime të vazhdueshme rinore.

Këtë vit nuk jepet Çmimi Nobel për Letërsi

PRISHTINË, 4 MAJ - Akademia Suedeze ka njoftuar se këtë vit nuk do të ketë fitues të Çmimit Nobel për Letërsi, pas skandalit për akuza për sulme seksuale.

Tetëmbëdhjetë gra kanë akuzuar për sulme seksuale fotografën francez Jean-Claude Arnault, që është i martuar me anëtarën e Akademisë dhe autoren Katarina Frostenson.

Frostenson është larguar nga organizata, sikurse udhëheqësi i Akademisë dhe katër anëtarë të tjerë. Akademia ka thënë se vitin e ardhshëm do të njoftojë për fituesin e çmimit për vitin 2018 dhe

2019. Ky rast përbën skandalin më të madh për këtë çmim prej kur ka nisur të ndahet më 1901. Po ashtu, Akademia ka bërë me dije se vendimi është marrë për shkak të mungesës së besimit publik.

Disa anëtarë të Akademisë kanë thënë se çmimi duhet të ndahet për ta ruajtur traditën, mirëpo të tjerët kanë thënë se institucioni nuk është në gjendje për të bërë një gjë të tillë. Përveç gjashtë vjetëve gjatë kohës së luftërave botërore, vetëm më 1935 nuk është ndarë ky çmim për shkak se është konsideruar se nuk ka ndonjë person adekuat për të.



E rrallë

Pistoleta celular në shitje për 500 dollarë

Pistoleta e cila ngjan në një smartphone do të shitet për 500 dollarë në takimin vjetor të Shoqatës Kombëtare të Armëve që do të zhvillohet këtë javë në Dallas. Ky mund të quhet takimi më i madh vjetor në historinë 147-vjeçare të organizatës. Pistoleta celular është prodhuar nga një kompani Ideal Conceal.



BARSOLETA E DITËS



Gazetari: Axxhë, a silleni mirë me gruan?
Axxha: Valla bre axhë, kur t'i sjelli, në vend e la!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



FOTO E DITES



Një fëmijë me një maskë të vendosur në fytyrë ecën përkaj qenve të shfaqur në një distrikt pazaresh në Pekin. /AP/

Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



E jashtëzakonshme

Ngordhin 111 kuaj në Arizonën Veriore

Dhjetëra kuaj kanë ngordhur në Arizonën Veriore për shkak të thatësirës që mban në këtë zonë. Zëdhënësi i "Navajo Nation", Mihio Manus, ka pohuar se 111 kuaj ngordhën në pellg gjatë javës së kaluar. Arizona e Veriut po kalon një nga periudhat më të këqija të thatësirës.




DASHI

Jeni të shpërqendruar sot sepse po i mbyllni gjërat e rëndësishme në sekondë të fundit. Kjo ju ka vënë nën presion.



DEMI

Edhe pse duket se dita nuk do të mbyllet mirë, vetëm me një komunikim të shpejtë me partnerin do t'i jepni zgjidhje gjithçkaje.



BINJAKËT

Sot do t'ju realizohen të gjitha ëndrrat për karrierën dhe financat e mira. Fati po ju ndihmon më shumë sesa që duhet.



GAFORRJA

Do të keni disa debate të nxehta me partnerin për këndvështrimet e ndryshme me të cilat i shikoni gjërat.



LUANI

Doni të ndryshoni disa gjëra që i përkasin rutinës suaj të përditshme. Edhe ju vetë do ta keni pak vështirë në fillim të ambientoheni.



VIRGJËRISHA

Sot mbrëmja është shumë e këndshme si për një takim dashurie, po ashtu edhe për një mbledhje mes miqsh duke shijuar biseda interesante.



PESHORJA

Të gjitha vendimet tuaja sot do të kenë referencë një person të caktuar. Jeni në rrugën e duhur dhe e vetëdijshme për çfarë po bëni.



AKREPI

Sot dita ka uljet dhe ngritjet e veta dhe ju jeni në mes tyre duke përballuar çdo situatë mjaft mirë.



SHIGJETARI

Dita e sotme do të jetë e mbushur me takime dhe marrëveshje që nuk është se do të japin ndonjë zgjidhje përfundimtare për problemet tuaja.



BRICJAPI

Sot do t'i befasoni të gjithë me reagimin tuaj të cilin nuk e prishte askush. Duke qenë zakonisht të mbyllur e të qetë, shpërthimi i sotëm do të jetë çlirim.



UJORI

Nuk jeni të qetë sepse shumë çështje varen nga ju sot. Doni të bëni një zgjidhje sa më korrekte, por kjo gjë influencon në humorin tuaj.



PESHQIT

Fillimi i ditës ju gjen të mbin-garkuar me punë. Do të dëshironit disa ditë pushim, por kjo do të mbetet thjesht ëndërr në sirtar.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Rihanna flet për të dashurin



Këngëtarja Rihanna rrallëherë diskuton për jetën private. Ajo është e dashuruar kokë e këmbë në biznesmenin saudit Hassan Jameel. Rihanna dhe Jameel shpesh janë parë në pushime së bashku. "Më parë jam ndjerë në faj

kur ndaja kohë për veten, mirëpo mendoj se më parë nuk kam takuar dikë që ia vlen të shpenzoja kohën me të", ka thënë ajo. Gjithashtu, Rihanna ka folur edhe për linjat trupore të saj në intervistën për "Vogue"-n.

Kylie Jenneri merr një milion dollarë për një postim



Më e vogla e Kardashianëve, Kylie Jenner, është shndërruar në milionere për një kohë shumë të shkurtër. Kompania e saj e kozmetikës ka rezultuar shumë e suksesshme dhe pritet që në të ardhmen t'i rritet vlera. Kylie

Jenneri ka zhvilluar një rrjet social të barabartë me një milion dollarë për postim, ku përfshihen më tepër se 137 milionë ndjekës përmes platformave të ndryshme si "Instagram", "Facebook", "Snapchat" dhe "Twitter".



Rita Ora mban koncert në Kroaci

Rita Ora ka paralajmëruar publikimin e këngës së saj më të re përmes një postimi në llogarinë e vet në "Instagram". Këtë herë bukuroshja vjen me një bashkëpunim me këngëtaresh shqiptare Bebe Rexha, Cardi B dhe

Charli. Projekti i radhës do të titullohet "Girls" dhe do të publikohet më 11 maj. "Jam shumë e lumtur të lajmëroj ardhjen e këngës së re 'Girls' në bashkëpunim me disa gra të fuqishme që më kanë inspiruar shumë", ka shkruar Rita.

Paul McCartney nderohet nga Pallati Buckingham



Këngëtari 75-vjeçar Paul McCartney ka marrë titullin "Companion of Honour" nga Mbretëresha në Pallatin Mbretëror Buckingham. Paul McCartney ka pranuar këtë çmim për shërbimet që ka dhënë në muzikë. "Ky është një nder i madh për mua dhe për

familjen time. Tani po e mendoj sa krenar do të ndiheshin nëna dhe babi im nga Liverpuli po ta shihnin këtë", ka thënë Paul McCartney. Titulli "Companion of Honour" jepet për arritje të veçantë në nivel kombëtar.

DOKTRINAT E MËDHA MORALE



HUBERT GRENIER

Hubert Grenier (1929-1997) ka qenë profesor i filozofisë në Louis-le-Grand dhe filozof francez. Vepra më e njohur e tij është *Doktrinat e mëdha morale*.

Platoni

Platonizmi rëndom përkufizohet si filozofia e ideve. Në mënyrë më thelbësore u desh filozofia e shpirtit, pa të cilin nuk do të kishte filozofi. Filozofia tek Platoni merr kuptim vetëm në raport me shpirtin, sikurse shpirti, nga ana e tij, bëhet i prekshëm vetëm në raportin e tij me filozofinë. Shpirti e shfaq veten, fillon të frymojë në ekzistencën e vet vetëm duke filozofuar. Është filozofi ajo çka i flet shpirtit dhe flet për shpirtin. Ç'është shpirti, sipas Platonit? Një i mërguar në këtë botë. Që në zanafillë ai e kishte atdheun e tij tek ata që kuptoheshin në mes tyre, u shkëput prej atij vendi, dhe ra në një trup. Aty ndodhet i robëruar, në shumicën e rasteve, me një kujtesë të humbur e duke mos kujtuar asgjë ç'ka qenë më parë dhe duke e shpërfillur faktin e të qenit një shpirt. Atëherë ai bëhet mediokritet psikosomatik që e quajmë njeri, i zënë me çështjet e tij prej njeriu, të vëna në përdorim për gjëra mesquine, në rivalitete të fëlliqura. Platoni nuk ushqen asnjë dhembshuri kundrejt njeriut, këtij shpirti i cili nuk është më një i tillë dhe në mënyrë skandaloze vetëkënaqet teksa bën një jetë njerëzore. Aristoteli do t'i hedhë bazat e një antropologjie. Ai do të trajtojë në mënyrë shkencore natyrën e njeriut. Platoni nuk jep ndonjë gjë në zhanrin antropologjik, por nuk do të vonojë t'i japë të drejtë asaj çfarë nuk duhej të ekzistonte.

Njeriu nuk e përbën qëllimin e filozofisë, për faktin se ai nuk do të ishte në gjendje ta ndërtonte arsyen e ekzistencës së tij. Njeriu, i vetëkënaqur me statusin "njeri", e përbuz filozofinë, e kjo e fundit e përcmon atë. *Théétète*¹ veçon, vë në kundërshti, si relevant i dy llojeve patribute të përbashkëta, njeriun i cili nuk

është veçse njeri dhe filozofin i cili refuzon këtë rënie. Ky i fundit gjithashtu di si të sillet aq keq në mjedisin e krijesave të çuditshme që e rrethojnë. Që të gjithë do ta përqeshin këtë farë krijese. Kjo pasi ai nuk e luan lojën me rregullat e tyre.

Është e vetëkuptueshme që shpirti, duke mos qenë diçka i projektuar me dorë, s'mund të jetë tjetër veçse një problematikë e vazhdueshme. Është vërtet një mit, domethënë një genie e cila nuk ka qenësi veçse në diskurs dhe prej diskursit. Siç themi, e kam një shpirt vetëm me kusht që të flas për të dhe të shqetësohem për të. Si të vëmë re diçka që duket qartë, shpirtin, i cili është aq i paqartë tek pothuajse të gjithë njerëzit! Sokrati te *Gorgias*, ia shpjegon këtë Kaliktë-së. Kaliktë ndryshon në të ardhmen. Ai hallakatet shumë në këtë temë, aq sa shpërbëhet fare, i dëbuar pa pushim nga dëshirat në dëshira. Për Kaliktë-në gjithçka kalon, asgjë nuk ka rëndësi. Por Sokrati e paralajmëron se është diçka e cila, përmes asaj që kalon, mbetet aty. Kjo është ajo çka ai bën për veten. "Ajo që bëj në tërësi zhduket, ajo që bëj për veten mbetet. Unë do të jem gjithmonë ajo çka unë kam bërë për veten. Ç'është ai që mbart e lë gjurmët? Shpirti im. Këto shenja do të jepen në mënyrë të pashlyeshme. Për përjetësinë - vdekja këtu nuk ndryshon asgjë, unë do të isha ky shpirt, i bukur apo i shëmtuar. Për këtë arsye duhet kujdesur për cilësinë e shpirtit, të mos e poshtërojmë duke kryer një padrejtësi dhe, nëse fatkeqësisht e bëjmë diçka të tillë, duhet të pastrojmë këtë fëlliqësi duke pranuar të vuajmë".

Askush nuk e mendon pra shpirtin e tij pa menduar përjetësinë e tij. Nëse kjo përjetësi nuk është veçse një iluzion, Kaliktë-a ka të drejtë të vazhdojë të jetojë ashtu siç jeton, por ja që Kaliktë-a nuk mund të ketë të drejtë. Kësisoj përjetësia e shpirtit i imponohet filozofisë sikurse vetë principi i saj. Një princip, ai vendoset, çka do të thotë se ai duhet. Nëse do të qe e mundur të shfaqim, sipas një teoreme, këtë përjetësi, ajo do të pushonte së qeni diçka tek e cila filozofi duhet të besojë, ajo së cilës ne do t'i besonim vetëm po të ishim filozofë, nëse do ta kishim zgjedhur "rrezikun grishës". Gjithashtu, nga fundi i *Fedon* (*Fhédon*), në mbarim të vargut të argumenteve të tij shumë të rregullta, Sokrati, për ta zbutur entuziazmin e miqve, i paralajmëron se gjithë këto dëshmi në të mirë dhe në formën e duhur nuk kanë arritur veçse diçka *kanonike* (*de l'ikanon*), të përshtatshme, të mjaftueshme, të besueshme, por jo diçka absolutisht të sigurt. Te Platoni, e vetmja dëshmi vërtet e pakontestueshme e ekzistencës

së shpirtit, dhe kështu të jomoralitetit të tij, është, në këtë botë ku e gjithë kundërshtimi i mërzisë, bashkohen për ta përcmuar ekzistencën e filozofit, e njeriut që realizon pamundësinë njerëzore: të menduarit për shpirtin e tij.

Askush nuk do të depërtojë te Platoni nëse nuk do ta marrë seriozisht paralajmërimin e tij që përcakton se duhet filozofuar me gjithë shpirt. Për sofistin, këtë filozof armik të filozofisë, Platoni tregon se ai e ka shpirtin e vogël, të prekshëm, të lig. Ai e ekspozon me sqmë këtë shëmti tmeruese: një inteligjencë e pashpirt. Vetëm shpirti arrin ta perceptojë realitetin e gjërave sepse nën vështrimin e tij ato ndriçohen deri në shkëlqim të plotë. Platoni nuk pati ndërmend të ndërtonte një shkencë në kuptimin pozitiv që ne jemi mësuar t'i japim këtij termi. Jules Lagneau (*Zhyl Lanjo*) në artikullin e tij *Mbi metafizikën*, mbledhur në *Të shquarat mësimet dhe fragmente*, e ka analizuar në mënyrë të shkëlqyer: "Ajo çka gjërat janë, ose më mirë ajo çka ato duket se janë në zhvillimin e tyre të jashtëm, është çështje që duhet t'ua kërkojmë fizikanëve. Platoni nuk shqetësohet për këtë pjesë. Ai e përbuz këtë shkencë ku njeriu nuk mëson atë që atij i intereson, marrëdhënien e genieve ose, më saktë, të ideve, me veten, me principin e tij, të mirën. Sepse gjërat kanë dy lloje të ekzistencës, njëra e ndjeshme, domethënë e errët (e pakuptueshme), opake, e padepërueshme, mbi të cilën mendimi nuk ka ndikim, tjetra e kuptueshme, që nuk konsiston në atë që ato janë, por në atë që vlejnë, domethënë ajo çka ato janë për njeriun. Ja përse platonizmi nuk është as fizikë, 'një studim elementar i gjërave të konsideruara në vetvete', as një metafizikë, e parë si një lidhje e këtyre gjërave me disa principe po aq objektive sa ato, 'por saktësisht një dialektikë, domethënë një psikologji dhe moral, një studim analitik i gjërave tek njeriu, i njohurisë që ky i fundit merr, ekzistencën që bën, në përputhje me vetë natyrën e tij". Prandaj, ajo çka komentuesit tregojnë me shprehjen e botës së ideve nuk duhet të bëhet me imagjinatë në ultrabotë, në botë superiore, nuk është një botë tjetër, është gjithmonë po kjo botë, por e parë ndryshe, e parë më në fund me shpirt, në dritën e ideve të së mirës.

Por drita tregon vetëm atë që është e dukshme dhe e mira është se ka disa të vërteta. Gjithashtu, platonizmi i shmanget çdo moralizmi, në atë çka moralja aty shpërndahet gjithkund dhe nuk bëhet e dukshme askund. Ai për të nuk është rubrikë speciale, dialog i

veçantë. *Gorgias* nuk i ngjason më një manuali të moralit sa *Kritika e arsyes së kulluar* një manuali specifik të fizikës. Sidoqoftë, shtigjet nëpër të cilët Platoni pikë se pari na bën të kalojmë në të përpjetën metafizike, do ta marrin me vështrësi miratimin e moralistëve të fushës. Qoftë edhe "dialektika e dashurisë" e veprës *Banketi*. Ajo konstaton faktin se po ecën tashmë në rrugën e shpëtimit të tij njeriu i cili nuk mjaftohet të dojë një trup të vetëm të bukur, por i dëshiron të gjithë në morinë e tyre të pafund. I pabesi, i shthururi që nuk përmbush përfaqimin e asnjë trupi, meqenëse pashmangshmërisht do të zbulojë me të mirë nga ai që e mendonte si më të mirin, vuan nga një lloj zhgënjimi i vazhdueshëm për të përgatitur shpëtimit e tij për sa kohë që e mediton. Duke përcmuar disa bukuri të ndjeshme, ai mund të vendosë të hedhë gjatë, në një shkallë më të lart, një dëshirë deri në atë çast e frustruar. Kjo dëshirë ishte e mirë. Çdo dëshirë është e mirë në vrull e sipër. Një shpirt i larguar nga vendi i tij i lindjes, në një gjendje mungese, nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse të dëshirojë. Njeriu që kërkon ekstazën në zotërimin fizik nuk dorëzohet përpara asgjëje absolutisht të qortueshme. Ai vetëm se gabohet mbi atë çka është vërtet e dëshirueshme, pra nuk mund të gjejë atë që kërkon, nuk ia gjen volinë, nuk është i zoti, por edhe fajtor nuk është. Nuk do ta fajësojmë pra, por do të përpiqemi ta mësojmë në mënyrë që të kthehet në rrugën e drejtë, në rrugën filozofike në fund të së cilës bashkimi soditës ndaj kuptueshmes i siguron shpirtit kënaqësinë e përjetësisë që ai më kot e priste nga bashkimi mishtor (i mishit).

Sokrati tregonte se asgjë nuk është e keqe me vullnet të plotë, me dëshirën e saj të plotë, duke ditur se çdo dëshirë nuk është shkaktuar veçse nga një e mirë dhe se njeriu që bën veprën e keqe gjithashtu kishte parasysh dhe të mirën. Fatkeqësisht, ai e ka lënë veten të zaptohet nga një e mirë e gabuar, nga një e mirë mashtruese. Nëse me ligësi nënkuptohet injoranca, për këtë arsye virtyti është shkencë. Por nëse virtyti është shkencë, kjo është ngaqë shkenca është virtyt. Urtësia e konceptuar nga Platoni nuk nxirret nga një njohuri. Ajo nuk rezulton nga zbatim i saj. Ajo përzihet me të. Kur e zotërojmë këtë njohuri, nuk na duhet më ndihma e një morali që të shprehet me anë të urdhrave, ndalesave dhe sanksioneve të jashtme. Ky trajnim nuk është i përshtatshëm veçse për të paditurit. Kush sodit (duke meditar) bëhet ajo çka ai sodit, ai shkrihet në të. Kësisoj, përsos-


mëria e elementeve të kuptueshëm shpërhapet në shpirtin që është dashamirës ndaj jetës së vërtetë, jetës teorike, jetës filozofike.

Nga fillimi deri në fund platonizmi nuk mund të zhvillohet ndryshe veçse si doktrinë e dijes. Të dish, ja cili është caktimi i një shpirti, i një inteligjence. E bllokuar në të ndjeshmen e errët, kjo inteligjencë shuhet. Ajo do të shndritet vetëm kur të ketë kontakt me idetë. I përkiste gjenisë së Platonit, në një terren ku nuk nxisnin veçse intelektualizma të përthara, të ujste me gëzim të zjarrtë ushtrimin e pastër të intelektit. Tek asnjë mendimtar tjetër nuk do të shfaqet ky lloj vrulli në një gradë të tillë, kjo forcë që rërmben dhe i çon peshë shpirtit njerëzorë. Është oratori, është Protagora që ka gjithmonë në gojë fjalën e virtytit dhe mburret që është profesor. Protagora u mëson të tjerëve një virtyt të cilit nuk i beson; Platoni, meqë di mirë se ç'është virtyti, di gjithashtu se ai është i pamësueshëm, me fjalë të tjera morali nuk vendoset me anë të procesit të moralizimit. Po ashtu, nuk duhet as një profesor morali, madje as profesori i një filozofie, por një filozof që krijon filozofë. Ekziston, e këtë të mos e kalojmë në heshtje, në të kundërt një tjetër Platon, një tjetër drejtim i platonizmit, i ekspozuar në *Republika dhe Ligjet*. Nën konvertimin filozofik që u bie për pjesë vetëm disa shpirttrave, aty është mbarështruar zgjidhja e thjeshtë njerëzore, e shëndetshme nëse nuk është shpëtimtare (ose e dobishme), zgjidhja politike nga e cila njerëzit, integral me qytetin, formohen në racionalitetin e ligjeve të tij dhe marrin disa zakone. Platoni i urdhëron filozofit ta shkëpusë pjesën më të madhe të një aktiviteti, që ai do ta kishte dëshiruar, të gjithë të koncentruar mbi teorinë, në mënyrë që t'ia kushtojë drejtim të Shtetit, duke vënë në shërbim të masës së bashkëqytetarëve të tij dijen ndaj së cilës ata nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë.

(Nënkapitull i shkëputur nga vepra "Doktrinat e mëdha morale" të autorit Hubert Grenier, në proces përkthimi për shtëpinë botuese "Logos-A", përkthyer nga Verjon Fasho. Ky nënkapitull, me lejen e botuesit e të përkthyesit, është botuar në revistën "Akademia" dhe në gazetën "Epoka e re")

¹ Le Théétète është një dialog i Platonit mbi shkencën dhe përkufizimin e saj. Ky dialog është i pari i një serie prej tre ose katër dialogësh (Sofisti, Politika, Filozofi) (shën. i përk.).

Autor: Gazmend Morina - BENI	KËNGËTARJA NË FOTO 1	DEGË E MJEKËSISË	GJENDJE E MËRZITSHME	GURRA	ZAMBIA, ANGOLA	GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI KIMIK	KËNGËTARJA AMERIKANE XHONS	ASI, KAMPIONI (Sport)	EPOKA ERE	ZANORE	NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR (shq.)	BOTIMET	1					
MUAJ I SHENJTË I MYSLIMANËVE	◇								U ARRATISE HAPËSIRË QIELLORE (Poet.)									
FJALË TINGULLIMIT- UESE	◇									ADEM DEMACI KRYEQYTETI I KANADASË								
BARI I THARË	◇				ARTI I TË FOLURIT (pashq.) EMËR MASHKULLI MYSLIMAN													
FUTBOLLISTI SAMUEL ... (Inter)	◇			BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.) BENDI MUZIKOR ".... MAIDEN"														
VAJTIMI ME LOT	◇					PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA INTERESI BANKAR NGA KREDIA												
PERËNDESHA E DASHURISË ROMAKE (mit.)	◇				BASHKËTING- ËLLORE			KËNGËTARJA & AKTORJA E VJETËR MORENO	VENEZIA INSTITUTE MANAGEMENT NUMËR THEMELOR									
QË KA TË BËJË ME GJININË	◇				AKTORJA DOBROSHI EMËR MASHKULLI ITALIAN						ZANORE "A" në mes të dy "S"		VENDE, RRENJËS	↓	BANORËT E NJË QYTETI TONË ISMET MUNISHI	VLERËSIMI I NXËNËSIT NGA MESUESI	LUMË NË AUSTRI	
ZANORE	◇	INDIUM XEHESTAR			FUTBOLLISTI SHQIPTAR BAJRAMI ZANORE					DIKTATOR SOVJETIK (shq.) KLUB FUTBOLLI NORVEGJEZ								
SHKRONJA XVI & XVIII	◇		ZYRË NDIHME JURIDIKE	MALLKIMI KISHTAR BABAI											KËNGËTARI MUSHKOLAJ JARAN, SHOK			
FOLTORJA	◇				AKTORJA ... RINA DRAMË E SANTORIT			TURK I VJETËR VEPRA LETRARE							TITAN PJATA (krah.)			
BODRUMI I PJEVE	◇							DY BASHKË- TINGËLLORE KËNGËTARJA NË FOTO 2			CILI ME RADHË IRIDIUM, AMPER							SIMBOL I FESË MYSLIMANË, BESIM (shq.)
GATESË	◇				NOTË MUZIKORE	TENISTI I NJOHUR ENDI (shqip.)	◇								FNJËRI NGA VËLLEZËRIT FRASHËRI STADIUMI MË I MADH NË BRAZIL			
VEGËL MUZIKORE	◇			INVA MULA KYÇ		PATRIOTI PRIZRENI	◇								VËNIE E MINAVE NYNBERG, AUGSBURG			
EPOKA ERE	KOHA E CAKTUAR PËR PUNË BASHKËTING- ËLLORE					VEND I CEKËT NË NJË LUMË XHELAL (shk.)	◇			RROGA VJETORE E PAPËS PËREMËR PRONOR					ZANORE E QESHUR TALLËSE			
DERË E VOGËLË ME THUPRA A ME DEGË (shq.)					ISH DISENJATORI VERSAÇI AKTORI DESTANI (shq.)		◇				ABEDIN REXHA INTERNATIONAL PHONETIC ALPHABET				RINOR (perkdh.) BUFE, KAFENE (bised.)			
2					KUNDREJT MALLKIMI		◇								AI QË E KISHTË DOBËSI THEMBRËN INATOSJE			
LOUISIANA LIBRARY ASSOCIATION						◇	GJINI E KRUIMTARISË LETRARË FJALË POHUESE					ZANORE AKTORI EGJIPTIAN SHARIF			ENDE			
ZANORE						JOD, FOSFOR BIMË ME TË CILËN BËJMË PILAF	◇		FIGURË STILISTIKE DY BASHKË- TINGËLLORE									
PJESË E MOTORIT						◇			I PA GJAK SËPËR MODELJA ... HERZIGOVA									
ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. org.)						◇	AKTORJA HOLLIVUDIANE CATHERINE JONES ZANORE			PËREMËR VETOR DY BASHKË- TINGËLLORE								
INSEKT I MËRZITSHËM						◇		VINCENZA, INTER BASHKËTING- ËLLORE		YNDYR PËR FYTYRË AUSTRIA								
KUNDREJT I BARDHË		◇	KAPILAR I GJAKUT					TONI ANDERSON										



QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	BOURNEMOUTH - SWANSEA	3+	EVERTON - SOUTHAMPTON	GG	ROTHERHAM - BLACKPOOL	1
-------------------	-----------------------	----	-----------------------	----	-----------------------	---

Dyzetë minutat e paharrueshëm për Haxhi Zekën

Haxhi Zeka pa dyshim se ka qenë lojtari më i mirë në futbollin e Kosovës prej përfundimit të luftës. Zeka të enjten, pas katër vjetësh në pension, iu rikthye fushës së gjelbër për ta ndihmuar Besës të mos bjerë nga Superliga, por ky rikthim nuk ka rezultuar i suksesshëm, prandaj dyzetë minutat nga Flamurtari do të mbesin të pashlyer në kujtesën e ikonës së futbollit pejan



herë të para nga Superliga", ka deklaruar ai. Në fund, Zeka ka thënë se rënia e Besës është e rëndë për secilin dashamirës të futbollit jo vetëm në Pejë, por në gjithë Kosovën. "Kur një klub me traditën dhe sukseset e Besës bie nga Superliga, atëherë është e dhimbshme jo vetëm për qytet, por për të gjithë qytetarët e vendit. Të gjithë ishim të mërzhitur pas ndeshjes me Flamurtarin, por këto gjëra ndodhin në futboll dhe tash duhet të shikojmë nga e ardhmja", ka përfunduar Zeka.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 4 MAJ - Legjenda e futbollit të Kosovës, Haxhi Zeka, në moshën 44-vjeçare është rikthyer nga pensionimi, me synim që ta ndihmojë Besën të mos bjerë nga Vala Superliga e Kosovës në Futboll, por mundi i ikonës së Besës ka shkuar huq, sepse skuadra pejane pësoi humbje nga Flamurtari me rezultat 0-4 dhe tashti është tri pikë pas kësaj skuadre në renditjen tabelore.

"Kundër Flamurtarit u riktheva dhe luajta dyzetë minuta, duke mos u vërejtur nga futbollistët e tjerë. Asnjëherë nuk kam kursyer kur ka qenë klubi në pyetje dhe rikthimi im ndodhi për shkak të klubit, por pësuam humbje dhe tash e kemi të vështirë, mos të them të pamundur, mbijetesën. Gjatë karrierës sime kam refuzuar oferta të ndryshme, pasi nuk kam mundur kurrë t'ia rikthej shpinën klubit", ka thënë Zeka për "Epokën e re". Dyzetë minutat në ndeshjen

kundër Flamurtarit, Haxhi Zeka nuk do t'i harrojë kurrë, pasi janë të fundit në karrierën e tij të futbollit, kur Besa i humbet shpresat për ta siguruar edhe pozitën e barazhit. Sulmuesi legjendar ka thënë se në tri ndeshjet e fundit nuk do të paraqitet në fushë, por vetëm në bankinë si ndihmëstrajner. "Gjithçka ka

përfunduar për mua. Sikur të isha pyetur edhe kundër Flamurtarit nuk do të isha inkuadruar, por trajneri kërkoj një gjë të tillë dhe nuk e refuzova. Kur jam inkuadruar unë, rezultati ishte 0-2 dhe ishte e vështirë për të ndryshuar diçka. Pas kësaj ndeshje isha shumë i mërzhitur, pasi Besa po bie për

Besa në këtë edicion është përballur me probleme të mëdha si në shtabin teknik, me kushte të vështira financiare, deri te fondi i varfër i futbollistëve. Ndërkaq, tri ndeshjet e fundit që ky klub pritet t'i zhvillojë në elitë janë: kundër Trepçës '89, Vllaznisë së Pozharanit dhe Llapit.

Karateistët e Kosovës nuk pranojnë të garojnë në Serbi pa simbole shtetërore

PRISHTINË, 5 MAJ - Federata e Karatesë e Serbisë ka njoftuar se në Kampionatin Evropian të Karatesë, që pritet të mbahet këtë muaj në Novi Sad, Kosova do të marrë pjesë pa simbole shtetërore.



Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Karatesë së Serbisë, Kajica Kaliçanin, ka thënë se për një gjë të tillë, Federatën serbe e ka njoftuar Federata Evropiane e Karatesë. Por, nga Federata e Karatesë së Kosovës thonë se nuk kanë asnjë njoftim për vendim të tillë. Ismet Krasniqi, kryetar i Federatës së Karatesë së Kosovës, thotë se në rast se një vendim i tillë është i saktë, është i papranueshëm dhe paraqet shkelje të rregullave. Sipas tij, sportistët e Kosovës do të udhëtojnë për në Novi Sad, por nuk do të garojnë

në qoftë se Kosova nuk trajtohet e barabartë sikurse të gjitha shtetet e tjera. Sipas Kaliçaninit, Federata Evropiane e Karatesë i ka njoftuar se Kosova do të marrë pjesë pa simbole shtetërore dhe në rast se sportistët e Kosovës fitojnë ndonjë medalje, kjo do të ndodhë nën flamurin e Federatës Evropiane. "Në rast se ata vijnë, ndonjëse kjo ende nuk është e sigurt, theksimi i flamurit dhe i simboleve nuk do të jetë i mundur. Për këtë, me siguri se

janë të informuar nga Federata Evropiane", ka thënë Kaliçanin. Ndërkaq Krasniqi ka thënë se Federata e Karatesë e Kosovës nuk ka marrë ndonjë njoftim por, sipas tij, kjo do të ishte e papranueshme. "Ne nuk kemi marrë asnjë informatë për këtë nga Federata Evropiane e as nga Federata Botërore. Diçka e tillë është e papranueshme për ne dhe ata nuk kanë të drejtë ta bëjnë këtë. Kjo është shkelje e rregullave. Ne patëm propozuar që, nëse duan, të largohen të gjithë flamujt, por që një shtet mund t'i shfaqë simbolet dhe tjetri jo, kjo është shkelje e rregullave. Ne do të shkojmë në Novi Sad gjithsesi, por nuk do të garojmë në qoftë se nuk trajtohem njëjtë si të gjithë", tha Krasniqi për Radion Evropë e Lirë.

Drita e pret Lirinë, Prishtina përballlet me Gjilanin

PRISHTINË, 4 MAJ - Sot (e shtunë) dhe nesër (e diel) zhvillohen ndeshjet e radhës në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja e parë e Javës së 31-të zhvillohet sot në Skenderaj në mes të Drenicës dhe Feronikelit, kurse pesë ndeshjet e tjera zhvillohen të dielën. Kryesuesja e elitës, Drita, e pret skuadrën e Lirisë dhe synon pikët maksimale për t'iu ofruar edhe më shumë titullit të kampiones, kurse Prishtina, që është e dyta në tabelë, synon të mos dështojë në ndeshjen ndaj Gjilanit, e cila zhvillohet në Pejë.

Vala SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
Drenica - Feronikeli

Të dielën takohen:
Drita - Liria
Prishtina - Gjilani
Trepça '89 - Besa
Flamurtari - Vllaznia
Vëllaznimi - Llapi
(Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 16:00)



Mbështeten shenjëtarët Urata Rama dhe Drilon Ibrahim

PRISHTINË, 4 MAJ - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Komunën e Vitisë për sportistët Urata

Rama dhe Drilon Ibrahim. Memorandumi u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe nënkryetari i Komunës së

Vitisë, Hasan Aliu. Në bazë të këtij memorandum, të dy shenjëtarët që vijnë nga kjo komunë do të financohen nga Komuna e

Vitisë me nga 100 euro në muaj deri në fund të ciklit olimpik 2020. Komiteti Olimpik i Kosovës përmes Solidaritetit Olimpik të

Komitetit Olimpik Ndërkombëtar ua jep të dy sportistëve nga 150 dollarë në muaj, kurse nga buxheti i vet nga 100 euro.

Berisha: Edhe nëse shënoj 113 gola, më quajnë egoist

MELBOURNE, 4 MAJ - Besart Berisha është një nga lojtarët më të rëndësishëm të kampionatit australian, por është i pakënaqur me kritikën që i bëjnë shpesh-

herë. Ai thotë se opinioni është i ndarë dhe asnjëherë nuk mund të kënaqen të gjithë me atë që bën në fushën e lojës. "Kritikat? Ndonjëherë nuk

mund të fitosh si lojtar. Nëse shënon tre gola në një ndeshje, ata thonë se je egoist. Nëse nuk shënon fare, ata thonë se nuk është gjë e mirë. Nëse

shënon 113 gola, ata thonë se ai mendon vetëm për vete. Nuk mund të fitojmë. Unë thjesht vazhdoj ta bëj punën time ashtu si po e bëj", ka thënë Berisha.



Latifi më 22 korrik përballlet me brazilianin Teixeira

TIRANË, 4 MAJ - Pak ditë më parë ishte në Tiranë për ta promovuar sportin e arteve marciale mikse dhe takuar fansat e tij, kurse të premtën është zyrtarizuar rivali i tij. Shqiptari i vetëm i UFC-së, Ilir Latifi, do të duelojë më 22 korrik në Gjermani ndaj brazilianit Glover Teixeira, duel i vlefshëm për ngjarjen e UFC-Hamburgut. Kjo është një përballje e fortë mes dy rivalësh në peshën "light heavyweight", madje do të duelojnë për fitoret numrat 3 dhe 4 të këtij divizioni.

Teixeira, 10 fitore e 4 humbje në kafaz, vjen pas dy fitoreve në tri përballjet e fundit, ndërsa Latifi (14 fitore, 5 humbje e 1 barazim) ka fituar 5 nga 6 duelet e fundit. Kjo përballje pritet me interes, pasi fituesi mund ta marrë titullin kampion bote i



përkohshëm në këtë peshë dhe në të ardhmen të duelojë me kampionin e kësaj kategorie, Luke Rockhold. Për shqiptarin

ky është një shans i madh në karrierën e tij, pasi më në fund i jepet mundësia të duelojë për majat e këtij sporti.

Jamesi udhëheq Clevelandin drejt finales

OHIO, 4 MAJ - LeBron James e ka udhëhequr Cleveland Cavaliersin drejt finales në Konferencën e Lindjes në NBA. "Ylli" i Cavsit, një nga më të mirët në historinë e basketbollit amerikan, ishte i magjishëm në përballjen e dytë të serisë gjysmëfinale ndaj Toronto Raptorsit, me skuadrën e tij që fitoi 110-128 dhe thellon në 2-0 serinë e përballjeve. "Mbreti" James dhuroi spektakël në "Air Canada Centre", duke shënua 43 pikë, dhënë 14 asistime dhe kontrolluar 8 topa poshtë koshit. Ai shndërrohet në basketbollistin e vetëm në histori që realizon më shumë se 40 pikë, shoqëruar me 14 asistime, në ndeshjet e "play-off"-it. DeRozan nuk shkoi më shumë se 24 pikë për Raptorsin, ndërsa Lowry u ndal në 21 pikë. Vendësit zhvilluan një pjesë të parë të mirë, duke qëndruar gjatë gjithë kohës në kryesim, por nuk mund të bënin asgjë në dy periodat e fundit para LeBronit, që u shfaq mbi parket në një nivel jashtë normales. Dy sfida të humbura në "Air Canada Centre" e bëjnë edhe më të vështirë misionin për Raptorsin që, përtej cilësive në skuadër, nuk ka mundur t'i shmangë problemet karakteriale. Tashmë dy përballjet e radhës do të luhën në "Quicken



Loans Arena" të Clevelandit ku, falë mbështetjes së publikut vendës, LeBron me shokë do të kenë mundësi reale për ta mbyllur 4-0 serinë e gjysmëfinaleve me Toronton, raporton "Supersport". Boston Celticsi siguroi një fitore të madhe 108-103 brenda në "TD Garden" ndaj Philadelphia 76ers, duke përmbysur një disavantazh prej 22 pikësh të periodës së dytë. Bostoni tregoi më të mirën në pjesën e dytë, me një rezultat të pjesshëm 45-17, pas rikthimit mbi parket të Jaylen Brownit dhe for-

mës së shfaqur nga trashja Rozier-Tatum-Smart, me 60 pikë në total. Tentuan gjithçka në fund Redicku, Covingtoni dhe Embiid për ta kthyer rezultatin, por morën goditjen përfundimtare nga Rozieri dhe Horfordi, që e çuan në +5 pikë diferencën 6 sekonda para rënies së sirenës, duke shuar shpresat e 76ers qoftë për ta barazuar rezultatin brenda kohës së rregullt. Me serinë që shkon 2-0 për Celticsin, dy përballjet e radhës zhvendosen në "Wells Fargo Center" të Philadelphia.

SHKURT

Hajvalia - Mitrovica, finalja e Kupës

Hajvalia dhe Mitrovica janë kualifikuar në finale të Kupës së Kosovës në futboll në konkurrencën e femrave. Këto dy skuadra kanë shënuar fitore edhe në ndeshjet e kthimit gjysmëfinale. Hajvalia shënoi fitore bindëse kundër Malishevës, me rezultat 6:0. Tre golat i realizoi Zylfije Bajramaj, kurse me nga një gol kontribuan Bahtije Miftari, Kaltrina Biçkaj dhe Arta Rama. Ndërkaq, Mitrovica, pas fitores 3:1 në ndeshjen e parë, në ndeshjen e kthimit e ka mundur Kosovën (P) me rezultat të ngushtë, 1:0. Golin e vetëm të kësaj sfide e shënoi Blerta Kaçiu. Kësisoj, Hajvalia dhe Mitrovica, krahas garës për titull, do të luftojnë edhe për Kupë.

Wengeri, i mërztur pas eliminimit nga Liga e Evropës

Trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, është mërztur pas eliminimit të skuadrës së tij në gjysmëfinale të Ligës së Evropës nga Atletico Madridi. "Jam shumë i mërztur, shumë, shumë, shumë i mërztur. Unë ndihem sikur skuadra, shumë i mërztur dhe shumë i zhgënjyer, madje edhe shumë i frustruar sepse kur eliminohehi nga një kompeticion dhe keni paraqitje të tilla në 180 minuta sikur ne, është e vështirë për t'u pranuar. Na mungoi diçka në pjesën e sulmit. Ju shikoni numrin e mundësive që kemi krijuar në dy ndeshjet, më e pakta që mund të thoni është se jeni shumë të frustruar", ka thënë Wengeri.

Gafë e faqes së Ligës së Kampionëve, shpall fituesin përpara kohe

Faqja zyrtare e Ligës së Kampionëve ka bërë një gafë vërtetë të pafalshme. Në lajmërimin e saj për orën dhe finalistët e turneut ajo ka shpallur edhe fituesin, që është Liverpool. Të kuqtë vërtet kanë zhvilluar një sezon të jashtëzakonshëm, por në finale gjithçka mund të ndodhë. Një gafë e tillë është bërë edhe nga faqja e Romës përpara ndeshjes me Liverpoolin. Kur nuk ishte hedhur ende shorti, kryeqytetasit nxorën biletat në shitje pikërisht për këtë ndeshje. Kjo shton edhe më shumë zërat se organizatorët e këtij turneu ndërhyjnë më shumë sesa që u takon për të marrë vendime. Finalja e Kievit do të zhvillohet më 26 maj në Kiev.

Lëndohet Koscielny, mungon në Kupën e Botës

Me të gjitha gjasat, Laurent Koscielny nuk do të jetë në "Rusi 2018". Një tjetër emër i madh do t'i mungojë Botërorit të Rusisë. 32-vjeçari francez ka luajtur vetëm 12 minuta në gjysmëfinalen e Evropës Ligës ndërmjet Atletico Madridit dhe Arsenalit, e cila përfundoi me rezultat 1-0 për spanjollët. Koscielny është rrëzuar përtokë mes lotëve sepse kishte një dëmtim në thembër. Lotët shprehin qartë zhgënjimin e tij, që duket se do të jetë një frakturë që do ta mbajë gjatë jashtë fushës të lojës dhe Franca do t'i duhet të bëjë pa të në Botëror. Megjithatë, duhet të priten ende rezultatet e analizave, por përvoja ka treguar se këto dëmtime zgjasin.

Unitedi nuk e dëshiron Umtitin

Manchester Unitedi nuk e dëshiron më Samuel Umtitin në "Old Trafford". Lajmin e ka konfirmuar e përditshmja spanjolle "Marca". Francezi dëshiron kontratë të re me përmirësim të kushteve ekonomike, por Barça nuk ia plotëson këtë kërkesë 24 vjeçarit. Por, raportohet se Unitedi është tërhequr nga ideja për të nënshkruar me të në afatin kalimtar të verës. Interesim për mbrojtësin në fjalë ka treguar skuadra e PSG-së.


Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 Univerziteti i Kosovës - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”
 Prizren

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, aprovimit nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së të kërkesës nr. 2/88 të datës 25.04.2018 dhe nenit 13, paragrafi 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. DAUT MUSTAFA” Prizren

Nr.	Mjekë Specialistë	Repartit	Kërkohe
1.	Mjekë Specialistë - Kardiologë	Interno-Koronare me Mjekim Intenziv	3
2.	Mjekë specialistë- Peditar	Repartit Peditarije	2
3.	Mjekë Specialistë të emergjencës	Emergjencia	2
4.	Mjekë Specialistë – Oftalmolog	Repartit i Oftalmologjisë	1

Koeficienti i pagës: (8.4)
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit Përkatesë
Nr. i Referencës: 8/7
Data e shpalljes: 04.05.2018
Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

Përgjegjësit kryesorë të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokoll etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative.
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkohet mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.

- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës.
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës.
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional.
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë.
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera.
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit.
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve.
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale.
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitë profesionale dhe kolektiv në repart(njësi).
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj.
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka.
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore.
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike.
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lëmisë përkatëse;
- Përparesi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës, Mjekë specialist të lëmisë përkatëse, që nuk janë punësuar në Institucionet Publike Shëndetësore.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohen më këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Administratës


 Ma.Sc. e Juridikut Melinda Çollaku


Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 Univerziteti i Kosovës - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”
 Prizren

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, odobrenje od strane generalnog direktora SHSKUK (zahteva br. 2/8, dana 25.04.2018) i člana 13, stav 1.1 Statuta opšte bolnice, Upravni savet opšte bolnice raspisuje:

KONKURS

Institucije: Opšta Bolnica, Genel Hastane, “Prim. Dr. Daut Mustafa” Prizren.

Nr.	Doktor specialista	Odeljenje	Trazeno:
	Doktor specialista - Kardiologa	Interno-Koronare sa intenzivnog službe	3
	Doktor specialista - Peditar	Odeljenje Peditarije	2
	Doktor specialista za emergencu	Emergjencia	2
	Doktor specialista – Oftalmolog	Odeljenje Oftalmologije	1

Koeficijent zarade: (8.40)
Radna Vreme: Puno radno vreme.
Ugovor: Prema važećim zakonima
Izveštaj: Šefu Odeljenja
Referentni br. 8/7
Datum objavljivanja: 04.05.2018

I. Osnovna svrha posla – za specialista:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Glavne odgovornosti lekara specialista:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada.
- Obezbedi visok standard nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi.
- Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno.
- Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju.
- Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta.
- Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi.
- Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete,
- Vrši nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja.
- Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.
- Vrši konkretne zadatke kada je to potrebno u vezi sa profesijom stručnjaka koji je blisko.
- Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog rada individualnih i kolektivnih na radnom mestu,
- Angažuje osoblje koje radi u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- Obezbediti i razviti programe stručnog osposobljavanja,
- Vrši redovnu kontrolu (inspekciju objekata, opreme i inventara na radnom mestu).
- Proverite da li je okruženje je čist i bezbedan za sve,
- Upravlja potrošnog materijala i druge opreme,
- Obezbeduje efikasno sistema komunikacije za sve unutar institucije,
- Analizira i realizuje profesionalne protokole pacijenta,
- Učestvovanje u stručnim naučnim istraživanjima,
- Preduzima mere za povećanje menadžerskih kvalitete i jedinicu kolektivne na odeljenje (Jedinice)
- Izvršiti dodatne zadatke na osnovu njihove profesionalne kvalifikacije i upravljanje, itd
- Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu zasnovna na profesionalnom nivou tamo,
- Davanje stručne savjete u tumačenju o lečenju pacijenata i postavljanje dan tretmana,
- Odredi redosled i plan kliničko-laboratorijskih egzaminacija,
- Da bi se rad u klinici ambulatno i ispituje njihovu readmisiju.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetstu diplomu iz oblasti na osnovu specifičnosti institucije

Sposobnost / iskustvo i druge osobine potrebno:

- * Diploma Medicinskog fakulteta;
- * Licenca specijalista odgovarajuće kategorije;
- * Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- * Da ima dokazali veštine i efikasne komunikacije u pismeno i usmeno, imaju znanje službenih jezika u upotrebi;
- * Poznavanje rada sa kompjuterom je od suštinskog značaja i znanje engleskog jezika je povoljno;
- * Licna karta fotokopija ili privremeni boravak i
- * Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učesća u zapošljavanju: pravo da se prijave svi su državljani Republike Kosova odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje (traženi sa ovom konkursom) i imaju adekvatnu stručnu sposobnost za obavljanje zadataka.

Zbornik radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.

Podnošenje prijave: Prijave se uzimaju i dostavlja - Sektor kadrovski U prijavi treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruzi aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Direktor Administracije


 Ma.Sc. e Juridikut Melinda Çollaku



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti i Prizrenit i Klinikës Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren



03/L-212 sayılı İş Kanunu'nun 8. maddesinin 1. ve 2. fıkrası uyarınca, Konkur işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin desteğiyle, Kosova Üniversitesi Hastanesi ve Klinik Hastanesinin Genel Müdürü tarafından onayladığı 25.04.2018 tarihli 2/88 nr. uygulamanın ve Hastane Statüsü'nün 13 üncü maddesinin 1.1 fıkrasına göre Genel Hastane Yürütme Kurulu şunları bildirdi:

KONKUR

Kurum: Genel Hastane "Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" Prizren

Nr.	Uzman doktor	Bolum	Gereken
1.	Uzman doktor - Kardiyolog	Dahiliye - Koroner Yoğun Bakım	3
2.	Uzman doktor – Çocuk doktoru	Pediatri bolumu	2
3.	Acil uzman doktoru	Acil bolum	2
4.	Uzman doktor – göz doktoru	Oftalmoloji bolumu	1

Aylık maaşı, koefisiyent: (8.4)
Çalışma standardı: Tam program (haftada 40 saat)
İs Kontrati: Yürürlükteki mevzuata göre
Raporlar: İlgili bolumun Başkanına
Referans numarası: 8/7
Bildiri tarihi: 04.05.2018

İs yerinin ana hedefi:

Kalite ve miktar anlamında sahip olduğu mesleki düzeye dayalı olarak hizmetlerin sağlanması

Uzman doktorun genel sorumlulukları

- Bölüm Müdürünün ve diğer yönetim kadrosu ile birlikte, ait olduğu seviyedeki insan kaynakları, ekipman ve envanter tesislerini yönetir.
- Yüksek standartlarda hasta bakımı sağlar.
- Hasta ve çalışan personel için nezaket, bakım ve saygı.
- Çalışanlarla profesyonel işbirliği ve nezaket.
- Hastanın kabulü, muayenesi ve uygun tedavisi.
- Hastanın tıbbi dokümantasyonu (hastalık öyküsü, broşür, protokol vb.) ile düzenli kayıtları gerçekleştirir.
- Sağlık kurumunda yatan hastalara düzenli ziyaretler yapar.
- Ek istişare ziyaretleri için istekte bulunur.
- Çalışan personelin günlük görevlerinin gerçekleştirilmesini denetler.
- Yaptığı iş hakkında profesyonel fikirler verir.
- Çalıştığı kurumda iş arayanın gözetmeninin gerektirdiği diğer görevleri yerine getirir.
- Uzmanlık alanı için gerekli olduğunda özel görevler de yapar.
- İşyerinde bireysel ve kolektif çalışmalarının müfredatını hazırlamaktan sorumludur.
- Çalışan personelin günlük işlerini yerine getirmesini yürütür.
- Mesleki eğitim programları ve kursları sağlar ve geliştirir.
- Düzenli kontrol gerçekleştirir (işyeri, ekipman ve envanter denetimi).
- Herkes için temiz ve güvenli bir ortam sağlar.
- Masraf malzemeleri ve diğer ekipmanları yönetir.
- Kurum içindekiler için etkili bir iletişim sistemi sağlar.
- Profesyonel hasta tedavi protokolleri geliştirir ve uygular.
- Profesyonel bilimsel araştırmalara katılır.
- Bolum (birimlerin) mesleki ve toplu eğitimin yönetsel niteliklerini, arttırmak için önlemler alır.
- Mesleki ve yönetsel ve baska niteliklerine göre ek görevler yapar.
- Niteliksel anlamda sahip olduğu mesleki seviyeye göre sağlık hizmetlerinin sağlanması.
- Hasta tedavisine ve günlük terapinin belirlenmesine ilişkin profesyonel sözlü ve yazılı tavsiyelerde bulunur.
- Klinik laboratuvar tetkiklerinin düzenini ve planını belirler.
- Ayakta tedavi gören hastalar için ambulansla yapılan çalışmalara ve muayene kabullerine bağlı olarak çalışır.

Kurumun özelliklerine dayanan nitelik, deneyim, beceri ve kişisel özellikler:

- Tıp Fakültesinin Diploması
- İlgili uzmanın lisansı
- Özel sağlık eğitimi alan adayların yanı sıra Kosova sağlık sisteminin işleyişine ilişkin iyi bilgiye öncelik verilecektir.
- Kanıtlanmış ve etkili yazılı ve sözlü iletişim becerilerine sahip, kullanımda olan resmi dilleri bilme
- Bilgisayar çalışmalarının tanınması zorunludur ve İngilizce bilgisi önceliklidir.
- Fotokopi numarası veya geçici ikamet izni ve
- Doğum belgesi, fotokopi

İşe katılım şartı: Kosova Cumhuriyetinin bütün vatandaşları, Kamu Sağlığı Kurumlarında çalışmayan ilgili alanların uzman doktorlarını katılma hakkına sahiptir.

Rekabet prosedürleri: konkur, koşullarını yerine getiren tüm ilgili adaylara açıktır.

Konkurun kapanış tarihi: Medyadaki yayın tarihinden itibaren 15 gün.

Başvuru gönderme: Başvurular alınır, tamamlanır ve Personel Sektörüne sunulur.

Aplikasyonda iş unvanı ve referans numarasını açıkça belirtmelidir. Tüm belgeler ve profesyonel referanslar uygulamaya eklenmelidir. Bu konkur için gerekli kanıtlardan başka başvurular kabul edilmeyecektir.

Konkurun kapanış tarihinden sonra gönderilen başvurular ve eksik başvurular kabul edilmeyecektir.

Başvuru yapan adaylar, ilan edilen rekabete göre kanıt sunmalıdır, aksi takdirde konkurun koşullarını karşılamayan adaylarla görüşme yapılmayacaktır.

İdare Müdürü
Ma.Sc. e Juridikut Melinda Çollaku



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsimit dhe Edukim

Nr: 11/326

Me: 04.05.2018

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikësc. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Viti shkollor 2017/2018

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Tafil Kelmendi" në Balincë	Mesimdhënës i programit fillor	Zëvendësim	1	20

I. Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose çertifikatat), çertifikatat në vend të diplomes duhet të jenë të notorizuar të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmit të përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktura me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

Kriteret e kualifikimit: Fakulteti i Edukimit- programi fillor, Fakulteti i Mësuesisë jashtë sipë planifikohet me UA të MASHT-it Nr. 05/2015 dhe UA 06/2015

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përparë.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të verteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurojnë në shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Pësonat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **04.05.2018 më datën: 18.05.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkura) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org

Zyra e Personelit
Nr. 11-5255/2018
Klinë, me 26.05.2018

NJOFTIM PËR ZGJATJEN E PRANIMIT TE APLIKACIONEVE PËR KONKURSION PUBLIK
02-1110-2971/18 i dt 19.04.2018

Zyra e personelit, duke u mbështetur në procedurat e rekrutimit, njofton se zgjat edhe për 7 dite kalendarike pranimin e aplikacioneve për pozitat si në vijim:

- Zyrtar për Kulturë me numër reference: JP00032930
- Zyrtari për Trashëgëmi Kulturorë me numër reference: JP00032929

Arsyeja: Numër i pamjaftueshëm i aplikantëve.

Zyra e personelit
Xhavit Dauti

Kancelaria Osoblja
Br. 41-3217/2018
Klina, 07.05.2018

OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU ROKA PREDAJA APLIKACIJA ZA JAVNI KONKURS
02-1110-2971/18 od 19.04.2018

Kancelarija Osoblja, na osnovi postupaka zapošljavanja, obavestava da proizvuje rok apliciranja za jos 7 kalendarskih dana za pozicije kao sledece:

- Sluzbenika za Kulturu, broj referencije: JP00032930
- Sluzbenika za Kulturno nasledje, broj referencije JP00032929

Razlog: Nedovoljan broj aplikanata.

Kancelarija Osoblja
Xhavit Dauti

American Taste

SINCE 1905

RC cola

RC Refresher BITTER LEMON

RC Lemon Lime



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333